



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.17

Datë 7 mars 2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9469 datë 2.2.2006	Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane “Programi vjetor i veprimit CARDS 2005 për Shqipërinë””.....	541
Vendim i Kuvendit nr.21, datë 22.2.2006	Për rrëzimin e kërkesës për shkarkimin nga detyra të Kryetarit Kuvendit.....	566
	Rezolutë e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit të Shërbimit Civil për vitin 2005.....	567
Dekret nr.4790 datë 28.2.2006	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	568
Dekret nr.4791 datë 28.2.2006	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	568
Udhëzim i përbashkët i MF,MB nr.4,datë 27.2.2006	Mbi bashkëpunimin ndërmjet organeve tatimore qendrore dhe organeve të pushtetit vendor, lidhur me administrimin e taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.....	569
Vendim i ERE nr.14, datë 3.3.2006	Për dhënien e licencës për transmetimin e energjisë elektrike shoqërisë “Operatori i sistemit të transmetimit” sh.a. Tiranë.....	572

L I G J
Nr.9469, datë 2.2.2006

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË
KOMUNITETEVE EUROPIANE “PROGRAMI VJETOR I VEPRIMIT CARDS 2005 PËR
SHQIPËRINË””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane “Programi vjetor i veprimit CARDS 2005 për Shqipërinë””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4788, datë 24.2.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE FINANCIARE

KUSHTET SPECIALE

Komuniteti European, këtu e tutje referuar si “Komuniteti”, i përfaqësuar nga Komisioni i Komuniteteve Europiane, këtu e tutje referuar si “Komisioni”, nga njëra anë, dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, këtu e tutje referuar si “Përfituesi”, nga ana tjetër, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Natyra dhe qëllimi i veprimit

1.1 Komuniteti do të kontribuojë për financimin e programit “Programi vjetor i veprimit CARDS 2005 për Shqipërinë”, këtu e tutje referuar si “Programi” i cili është përshkruar në dispozitat teknike dhe administrative në shtojcën II.

1.2 Ky program do të zbatohet në përputhje me Marrëveshjen financiare dhe shtojcat e saj: kushtet e përgjithshme (shtojca I) dhe dispozitat teknike dhe administrative (shtojca II).

Qeveria do të ndryshojë destinacionin dhe përdorimin fillestar dhe/ose të synuar të pajisjeve të dërguara, ambienteve dhe godinave të restauruara pjesërisht dhe/ose plotësisht me fondet e Komunitetit, përveç rastit kur bihet dakord ndryshe me Komisionin.

Neni 2

Kontributi financiar i Komunitetit

- 2.1 Kostoja totale e programit është 44 200 000 euro.
- 2.2 Komuniteti merr përsipër financimin e shumës 44.2 milionë euro. Ndarja e kontributit financiar të Komunitetit sipas zërave të buxhetit është përshkruar në buxhetin e përfshirë në dispozitat teknike dhe administrative në shtojcën II.

Neni 3

Kontributi i Përfituesit

Aty ku, një pjesë apo i gjithë kontributi i Përfituesit është i një natyre jofinanciare, rregullat e detajuara do të përcaktohen në një memorandum mirëkuptimi të veçantë në lidhje me çdo program/projekt.

Neni 4

Periodha e ekzekutimit

Periodha e ekzekutimit të Marrëveshjes financiare do të fillojë në momentin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë, e shumta në datën 31.12.2014. Kjo periudhë ekzekutimi do të përfshijë dy faza: një fazë operative të zbatimit, e cila do të fillojë në momentin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë në datën 31.12.2012. Nga kjo datë do të fillojë faza e mbylljes, e cila do të përfundojë në fund të periudhës së ekzekutimit.

Neni 5

Afat i për nënshkrimin e kontratave të zbatimit të Marrëveshjes financiare

Kontratat e zbatimit të Marrëveshjes financiare do të nënshkruhen, e shumta, brenda datës 2.9.2008. Ky afat nuk mund të shtyhet.

Neni 6

Adresat

Të gjitha komunikimet, në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes financiare, do të jenë të shkruara, do t'i referohen shprehimisht programit dhe do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

a) Për Komisionin
Z.Dirk Meganeck-Drejtor
Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit
CHAR 04/99-Rue de la Loi 200
B-1049 Bruksel, Belgjikë
Fax:+32 2 295 74 82

b) Për Përfituesin
Znj.Arenca Trashani
Ministër i Integritetit Europian
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri
Fax:+355 4 25 62 67

Neni 7

Shtojcat

7.1 Dokumentet e mëposhtme do t'i bashkëngjiten kësaj Marrëveshjeje dhe do të përbëjnë pjesë integrale të saj:

Shtojca I: Kushtet e përgjithshme

Shtojca II: Dispozitat teknike dhe administrative

7.2 Në rast të një konflikti midis dispozitave të shtojcave dhe atyre të kushteve speciale të Marrëveshjes financiare, dispozitat e kushteve speciale do të kenë përparësi. Në rast të një konflikti midis dispozitave të shtojcës I dhe atyre të shtojcës II, dispozitat e shtojcës I do të kenë përparësi.

Neni 8

Kushte të tjera speciale të zbatueshme për programin

8.1 Kushtet e përgjithshme plotësohen nga dispozitat e mëposhtme:

Me qëllim që të sigurohet një zbatim efektiv i kësaj Marrëveshjeje financiare, Përfituesi do të

ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që:

- Ekspertët e kontraktuar nga Komisioni për zbatimin e programit lidhur me këtë Marrëveshje financiare do të gëzojnë mbrojtjen e tij dhe do t'u jepen lejekalimi të nevojshme për të bërë të mundur lëvizjen e lirë të tyre brenda territorit të Shqipërisë.

- Të gjithë personelit që merr pjesë në zbatimin e programit dhe anëtarëve të afërt të familjeve të tyre do t'u akordohen përfitime jo më pak të favorshme, privilegje dhe përjashtime si ato që u akordohen zakonisht të punësuarve të tjerë të stafit ndërkombëtar në Shqipëri, sipas çdo marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe për ndihmë ekonomike.

- Të gjithë personelit që merr pjesë në zbatimin e programit dhe anëtarëve të afërt të familjeve të tyre t'u lejohet hyrja në Shqipëri për t'u vendosur për të punuar dhe për t'u larguar nga Shqipëria ashtu siç parashikohet në kontratë. Item.

-Të gjitha lejet e nevojshme për importimin e pajisjeve për këtë program, si dhe lejet e kërkuara për riekportimin e po të njëjtave sende do të jepen.

-Të gjitha importet e kryera nën këtë Marrëveshje financiare do të përjashtohen nga taksat e doganave, detyrimet eksportuese ose taksa dhe ngarkesa të tjera fiskale.

-Të gjitha prokurimet publike të pajisjeve dhe shërbimeve të zhvilluara nën këtë Marrëveshje financiare do të përjashtohen nga taksat e shitjeve ose tarifave të tjera fiskale të të njëjtës natyrë.

-Në të gjitha këto raste, Përfituesi do të sigurojë bashkëpunim të plotë me autoritetet përkatëse.

- Përveç të tjerash, Përfituesi do të sigurojë akses në kompanitë shtetërore dhe institucione të tjera qeverisëse, të cilat do të përfshihen ose janë të nevojshme për zbatimin e programit.

Në rast vështirësish në zbatimin e Programit, palët bien dakord të konsultohen menjëherë, me qëllim që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të zgjidhur këto vështirësi.

Importi dhe riekportimi i pajisjeve

Përfituesi duhet të japë lejet e nevojshme për importimin e pajisjeve profesionale të kërkuara për të ekzekutuar masat që i nënshtrohen ligjeve ekzistuese, rregullave dhe rregulloreve të marrësit.

Përfituesi duhet t'u japë personave fizikë dhe juridikë që kanë ofruar punime, pajisje ose kontrata shërbimesh, lejet e kërkuara për riekportimin e pajisjeve në fjalë.

Neni 9

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes financiare

Marrëveshja financiare do të hyjë në fuqi në datën në të cilën ajo do të nënshkruhet nga pala e fundit.

Bërë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze, një kopje për Komisionin dhe një kopje për Përfituesin.

Për Komisionin

Z.Dirk Meganeck-Drejtor

Drejtorja e Përgjithshme e Zgjerimit

Bruksel

Për Përftuesin

Znj.Arenca Trashani

Ministër i Integrimit European

Tiranë

Deklaratë: Përsa i përket nenit 9, kjo Marrëveshje financiare do të hyjë në fuqi për palën shqiptare në datën e hyrjes në fuqi të ligjit për ratifikimin e saj nga Kuvendi i Shqipërisë.

MINISTRI I INTEGRIMIT EUROPIAN

Arenca Trashani

SHTOJCA I

KUSHTET E PËRGJITHSHME

TITULLI I

FINANCIMI I PROJEKTIT/PROGRAMIT

Neni 1

Parime të përgjithshme

1.1 Kontributi financiar i Komunitetit do të kufizohet nga shuma e përcaktuar në Marrëveshjen financiare.

1.2 Dhënia e financimit nga Komuniteti do të kushtëzohet nga plotësimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje financiare nga ana e Përfituesit.

Neni 2

Tejkalimi i kostove dhe mbulimi i tyre

2.1 Tejkalimet individuale të zërave të buxhetit të Marrëveshjes financiare do të trajtohen me anë të rishpërndarjes së fondeve të buxhetit të përgjithshëm, në përputhje me nenin 17 të këtyre kushteve.

2.2 Në qoftë se ekziston një rrezik i tejkalimit të shumës totale të përcaktuar në Marrëveshjen financiare, Komisioni mund, ose të zvogëlojë projektin/programin, ose të kërkojë angazhimin e burimeve financiare të Përfituesit apo burime të tjera jokomunitare.

2.3 Në qoftë se projekti/programi nuk mund të zvogëlohet ose në qoftë se tejkalimi nuk mund të mbulohet as nga fondet e Përfituesit apo burime të tjera, Komisioni mund të japë, në mënyrë të jashtëzakonshme, financime komunitare shtesë. Në këtë rast, kostot shtesë do të financohen pa cenuar rregullat dhe procedurat e Komunitetit, duke çelur një kontribut financiar shtesë, i cili do të përcaktohet nga Komisioni.

TITULLI II ZBATIMI

Neni 3

Parime të përgjithshme

3.1 Projekti/programi do të zbatohet nga Komisioni duke vepruar për dhe në emër të Përfituesit.

3.2 Komisioni do të përfaqësohet në shtetin e Përfituesit nga kryetari i delegacionit të tij.

Neni 4

Periudha e ekzekutimit

4.1 Periudha e ekzekutimit të Marrëveshjes financiare do të fillojë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë në datën e përcaktuar në nenin 4 të kushteve specifike.

4.2 Kjo periudhë ekzekutimi do të përfshijë dy faza:

- një fazë operative zbatimi, ku kryhen veprimtaritë kryesore. Kjo fazë do të fillojë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë 24 muaj përpara fundit të kohës së ekzekutimit;

- faza e mbylljes, gjatë së cilës do të kryhen kontrollet financiare dhe vlerësimi, si dhe do të mbyllen teknikisht dhe financiarisht kontratat për zbatimin e Marrëveshjes financiare. Kjo fazë do të fillojë në datën e përfundimit të fazës operative të zbatimit dhe do të përfundojë e shumta 24 muaj pas kësaj date.

4.3 Kostot që rrjedhin nga aktivitetet kryesore do të jenë të pranueshme për financimin e Komunitetit vetëm në qoftë se ato kanë lindur gjatë fazës operative të zbatimit. Kostot që rrjedhin nga kontrolli financiar përfundimtar, vlerësimi dhe mbyllja e aktiviteteve do të jenë të pranueshme deri në fund të fazës së mbylljes.

4.4 Çdo fond i mbetur nga kontributi i Komunitetit do të fshihet automatikisht gjashtë muaj pas përfundimit të periudhës së ekzekutimit.

4.5 Në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara siç duhet, mund të paraqitet një kërkesë për zgjatjen e fazës operative të zbatimit dhe, rrjedhimisht, të periudhës së ekzekutimit. Në qoftë se zgjatja e afatit kërkohet nga Përfituesi, kërkesa duhet të paraqitet të paktën tre muaj përpara përfundimit të fazës operative të zbatimit dhe të miratohet nga Komisioni përpara kësaj date.

4.6 Në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara siç duhet dhe pas përfundimit të fazës operative të zbatimit, mund të paraqitet një kërkesë për zgjatjen e afatit të fazës së mbylljes dhe, rrjedhimisht, të periudhës së ekzekutimit. Në qoftë se zgjatja e afatit kërkohet nga Përfituesi, kërkesa duhet të paraqitet të paktën tre muaj përpara përfundimit të fazës së mbylljes dhe të miratohet nga Komisioni përpara kësaj date.

TITULLI III LIDHJA E KONTRATAVE DHE DHËNIA E GRANTEVE

Neni 5

Parime të përgjithshme

Të gjitha kontratat e zbatimit të Marrëveshjes financiare duhet të lidhen në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për zbatimin e operacioneve të jashtme, në fuqi në momentin e nisjes së procedurave në fjalë.

Neni 6

Afati përfundimtar për nënshkrimin e kontratave të zbatimit të Marrëveshjes financiare

6.1 Kontratat e zbatimit të Marrëveshjes financiare duhet të nënshkruhen nga të dyja palët brenda tre vjetësh nga miratimi i angazhimit buxhetor nga Komisioni, pra e shumta deri në datën e caktuar në nenin 5 të kushteve specifike. Ky afat nuk mund të shtyhet.

6.2 Norma e mësipërme nuk do të aplikohet për kontratat e kontrollit financiar dhe të vlerësimit, të cilat mund të nënshkruhen edhe më vonë.

6.3 Në datën e përmendur në nenin 5 të kushteve specifike, çdo fond për të cilin nuk është nënshkruar ndonjë kontratë nuk janë nënshkruar, do të fshihet.

6.4 Çdo kontratë për të cilën nuk ka filluar asnjë pagesë brenda tre vjetësh nga nënshkrimi i saj do të përfundojë automatikisht dhe fondet e saj do të fshihen.

Neni 7

Pranueshmëria

7.1 Pjesëmarrja në ftesat për tendera për kontratat për punime, furnizime ose shërbime është e hapur në kushte të barabarta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të shteteve anëtare të Komunitetit dhe në përputhje me kushtet specifike të akteve bazë rregullues të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të vendeve të treta përfituese ose të çdo vendi tjetër të tretë të përcaktuar shprehimisht në këto akte.

7.2 Pjesëmarrja në konkurset për propozime është e hapur në kushte të barabarta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të shteteve anëtare të Komunitetit dhe në përputhje me kushtet specifike të akteve bazë rregullues të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, prë të gjithë personat fizikë dhe juridikë të vendeve të treta përfituese ose të çdo vendi tjetër të tretë përcaktuar shprehimisht në këto akte.

7.3 Në mënyrë të jashtëzakonshme, në raste të justifikuara të miratuara nga Komisioni, mund të vendoset që, në bazën e kushteve specifike të përcaktuar në aktet bazë rregulluese të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, të lejohen shtetasit e vendeve të treta, të ndryshëm nga ata të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2, të marrin pjesë në tenderat për kontrata.

7.4 Mallrat dhe furnizimet e financuara nga Komuniteti dhe të nevojshme për përmbushjen e kontratave të punimeve, furnizimeve dhe shërbimeve, si dhe të procedurave të prokurimit të nisura nga përfituesi i grantit për ekzekutimin e aktivitetit të financiar, duhet të kenë origjinën e tyre në vende të pranueshme për të marrë pjesë, siç përcaktohet në tre paragrafët e mësipërm.

7.5 Ky rregull i kombësisë do të aplikohet gjithashtu për ekspertët e propozuar nga ofruesit e shërbimeve, të cilët do të marrin pjesë në procedurat e tenderave ose në kontratat e shërbimeve të financuara nga Komuniteti.

TITULLI IV
RREGULLAT E ZBATUESHME PËR PËRMBUSHJEN E KONTRATAVE

Neni 8

E drejta e vendosjes dhe e qëndrimit

8.1 Kur justifikohet nga natyra e kontratës, personat fizikë dhe juridikë që marrin pjesë në ftesat për tendera për kontratat e punimeve, furnizimeve ose shërbimeve do të gëzojnë të drejtën e përkohshme të vendosjes dhe të qëndrimit në vendin e Përfituesit. Kjo e drejtë do të jetë e vlefshme për një muaj pas dhënies së kontratës.

8.2 Kontraktorët (duke përfshirë përfituesin e grantit) dhe personat fizikë, shërbimet e të cilëve janë të nevojshme për përmbushjen e kontratave, si dhe anëtarët e familjeve të tyre do të gëzojnë të drejta të ngjashme gjatë zbatimit të projektit/programit.

Neni 9

Normat tatimore dhe doganore

9.1 Përveç rasteve ku parashikohet në kushtet speciale, tatimet, detyrimet doganore dhe detyrime të tjera (duke përfshirë TVSH-në ose taksa ekuivalente) do të jenë të përjashtuara nga financimi i Komunitetit.

9.2 Shteti përfitues duhet të aplikojë për kontratat e prokurimeve dhe grantet e financuara nga Komuniteti normat tatimore dhe doganore më të favorizuara, të aplikuara për shtetet ose organizatat e zhvillimit ndërkombëtar me të cilat ai ka marrëdhënie.

9.3 Aty ku Marrëveshja kuadër ose shkëmbimi i letrave të aplikueshme përfshin norma më të detajuara mbi këtë çështje, ato duhet të aplikohen gjithashtu.

Neni 10

Normat mbi kursin e këmbimit

10.1 Shteti përfitues merr përsipër të autorizojë importin ose blerjen e valutës së huaj të nevojshme për zbatimin e projektit. Ai merr përsipër gjithashtu të aplikojë normativën e tij kombëtare për këmbimin e valutës në një mënyrë jodiskriminuese për kontraktorët që lejohen të marrin pjesë sipas nenit 7 të këtyre kushteve.

10.2 Aty ku marrëveshja kuadër ose shkëmbimi i letrave të aplikueshme përfshin norma më të detajuara mbi këtë çështje, ato duhet të aplikohen gjithashtu.

Neni 11

Përdorimi i të dhënave nga studimet

Aty ku Marrëveshja financiare përfshin financimin e një studimi, kontrata në lidhje me këtë studim, nënshkruar për zbatimin e Marrëveshjes financiare, duhet të rregullojë pronësinë e këtij studimi, si dhe të drejtat e Përfituesit ose të Komisionit për të përdorur të dhënat në studin, për ta publikuar atë ose për t'ua dhënë palëve të treta.

Neni 12

Alokimi i fondeve të rikthyera nga kontratat

12.1 Fondet e rikthyera nga pagesat e kryera gabimisht nga garancitë e pagesave parafinancuese ose nga përfitimet që rrjedhin nga garancitë e ofruara në bazë të kontratave të financuara sipas kësaj Marrëveshjeje financiare, duhet të alokohen për projektin/programin.

12.2 Ndëshkimet financiare të vendosura nga autoriteti kontraktues ndaj një kandidati apo

pjesëmarrësi në tender, i cili hyn në rastet e përjashtimit në kuadrin e një kontrate prokurimi, kërkesa për garancitë e tenderit, si dhe dëmet që i shkaktohen Komisionit, do t'i ripaguhet buxhetit të përgjithshëm të Komuniteteve Europiane.

TITULLI V DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 13 **Transparenca**

13.1 Çdo projekt/program i financuar nga Komuniteti do të jetë objekt i operacioneve të përshtatshme informuese dhe komunikuese. Këto veprime do të përcaktohen me miratimin e Komisionit.

13.2 Këto operacione informuese dhe komunikuese duhet të kryhen sipas rregullave të përcaktuara e të publikuara nga Komisioni për transparencën e aktiviteteve të jashtme, në fuqi në momentin e kryerjes së këtyre veprimeve.

Neni 14 **Parandalimi i parregullsisë, mashtrimit dhe korrupsionit**

14.1 Përfituesi duhet të marrë masat e përshtatshme për të parandaluar parregullsitë dhe mashtrimet dhe, me kërkesë të Komisionit, të nisë ndjekjet penale për rikthimin e fondeve të paguara gabimisht. Përfituesi do të informojë Komisionin për çdo masë të marrë.

14.2 “Parregullsi” do të thotë çdo shkelje e Marrëveshjes financiare, kontratave të zbatimit ose të së drejtës komunitare, i cili shkaktohet si pasojë e një veprimi ose mosveprimi të një operatori ekonomik, dhe që ka ose do të kishte si efekt cenimin e buxhetit të përgjithshëm të Komuniteteve Europiane ose të buxheteve të administruara prej tyre, duke pakësuar ose duke humbur të ardhura që rrjedhin nga burime të tyre të mbledhura direkt në emër të Komuniteteve Europiane ose nga çdo zë i pajustificuar shpenzimi.

“Mashtrim” do të thotë çdo veprim ose mosveprim i qëllimshëm që lidhet me:

- përdorimin ose paraqitjen e dokumenteve ose deklaratave të rreme, jokorrekte ose të paplota, të cilat kanë si efekt të tyre përvetësimin ose mbajtjen e padrejtë të fondeve nga buxheti i përgjithshëm i Komuniteteve Europiane ose nga buxhetet e administruara prej tyre ose në emër të tyre;
- mosdhënien e informacionit në kundërshtim me detyrimet specifike, me të njëjtin efekt;
- keqpërdorimin e këtyre fondeve për qëllime të tjera të ndryshme nga ato për të cilat janë ofruar fillimisht.

Përfituesi do të informojë menjëherë Komisionin për çdo element që sillet në vëmendjen e tij, i cili lë për të dyshuar për parregullsi ose mashtrim.

14.3 Përfituesi merr përsipër të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për të ndrequr çdo praktikë korruptive pasive ose aktive, çfarëdo qoftë ajo, në çdo fazë të procedurës për dhënien e kontratave ose granteve ose në zbatimin e kontratave që lidhen me të. “Korrupsion pasiv” do të thotë veprim i paramenduar i një nëpunësi, i cili, direkt ose me anë të një ndërmjetësi, kërkon ose përfiton avantazhe të çdo lloji, çfarëdo qoftë ky, për veten e tij ose për një palë të tretë, ose pranon një premtim për një përfitim të tillë, për të vepruar ose për t’u shmangur nga veprimi në përputhje me detyrën e tij ose në ushtrimin e funksioneve të tij, duke shkelur detyrat e tij funksionale, veprim që ka ose do të kishte si efekt cenimin e interesave financiare të Komuniteteve Europiane. “Korrupsion aktiv” do të thotë veprim i paramenduar i cilitdo që, direkt apo nëpërmjet një ndërmjetësi, i premtim ose i jep një avantazh të çdo lloji, çfarëdo qoftë ai, një nëpunësi për veten e tij ose për një palë të tretë, për të vepruar ose për t’u shmangur nga veprimi, në përputhje me detyrën e tij ose në ushtrimin e funksioneve të tij, duke shkelur detyrat e tij funksionale, veprim që ka ose do të kishte si efekt cenimin e interesave financiare të Komuniteteve Europiane.

Neni 15

Verifikimet dhe kontrollet nga Komisioni, Zyra Europiane Kundër Mashtrimit (OLAF) dhe Gjykata e Kontrollit Financiar e Komuniteteve Europiane

15.1 Përfituesi bie dakord që Komisioni, OLAF dhe Gjykata e Kontrollit Financiar e Komuniteteve Europiane të kryejnë kontrolle dokumentacioni apo në vend mbi përdorimin që i është bërë financimit të Komunitetit sipas Marrëveshjes financiare (duke përfshirë procedurat për dhënien e kontratave dhe granteve), si dhe të kryejnë një kontroll financiar të plotë, nëse është e domosdoshme, në bazë të dokumenteve mbështetëse të llogarive dhe dokumenteve kontabël, si dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me financimin e projektit/programit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes, si dhe për shtatë vjet pas datës së pagesës së fundit.

15.2 Përfituesi bie dakord gjithashtu që OLAF mund të kryejë kontrolle në vend dhe verifikime në përputhje me procedurat e përcaktuara nga e drejta komunitare për mbrojtjen e interesave financiare të Komuniteteve Europiane kundër mashtrimit dhe parregullsive të tjera.

15.3 Për këtë qëllim, Përfituesi merr përsipër t'u japë nëpunësve të Komisionit, të OLAF dhe të Gjykatës së Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane, si dhe përfaqësuesve të tjerë të autorizuar, mundësinë e hyrjes në vendet dhe ambientet në të cilat aktivitetet e financuara sipas Marrëveshjes financiare janë kryer, duke përfshirë sistemet e tyre kompjuterike, si dhe çdo dokument ose të dhënë të informatizuar që lidhet me administrimin teknik dhe financiar të këtyre aktiviteteve, si dhe të marrë përsipër çdo masë që është e nevojshme për të lehtësuar punën e tyre. Kjo mundësi hyrjeje për përfaqësuesit e autorizuar të Komisionit Europian, të OLAF dhe Gjykatës së Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane do të jepet në kushtet e një konfidencialiteti të plotë lidhur me palët e treta, duke mos cenuar detyrimet që rrjedhin nga e drejta publike të cilave ato i nënshtrohen. Dokumentet duhet të jenë të konsultueshme dhe të arkivuara në një mënyrë që të lejojë inspektim të lehtë të tyre. Përfituesi është i detyruar të njoftojë Komisionin, OLAF ose Gjykatën e Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane për vendin e saktë ku ruhen këto dokumente.

15.4 Kontrolltet dhe kontrollet financiare të përmendura më sipër do të aplikohen edhe për kontraktorët dhe nënkontraktorët të cilët kanë përfutur financime të Komunitetit.

15.5 Përfituesi do të njoftohet mbi misionet e kontrollit në vend nga përfaqësuesit e emëruar nga Komisioni, OLAF ose Gjykata e Llogarive.

Neni 16

Konsultimet midis Komisionit dhe Përfituesit

16.1 Përfituesi dhe Komisioni do të konsultojnë njëri-tjetrin përpara paraqitjes së çdo mosmarrëveshjeje në lidhje me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje financiare.

16.2 Konsultimet mund të çojnë në ndryshimin, ndërprerjen ose përfundimin e Marrëveshjes financiare.

Neni 17

Ndryshimet në Marrëveshjen financiare

17.1 Çdo ndryshim për shtojcën II të Marrëveshjes financiare do të bëhet me shkrim dhe do të jetë objekt i një shtojce.

17.2 Në qoftë se kërkesa për një ndryshim vjen nga Përfituesi, ky i fundit duhet t'ia paraqesë kërkesën Komisionit të paktën tre muaj përpara datës së propozuar për hyrjen në fuqi të shtojcës, me përjashtim të rasteve të justifikuara siç duhet nga Përfituesi dhe të pranuar nga Komisioni.

17.3 Rastet specifike të zgjatjes së afatit të fazës operative të zbatimit ose fazës së mbylljes janë të rregulluara nga neni 4(5) dhe (6) i këtyre kushteve.

Neni 18

Pezullimi i Marrëveshjes Financiare

18.1 Marrëveshja financiare mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Komisioni mund ta pezullojë zbatimin e Marrëveshjes financiare, në qoftë se Përfituesi shkel detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja financiare.

b) Komisioni mund ta pezullojë Marrëveshjen financiare, në qoftë se Përfituesi shkel një detyrim që lidhet me të drejtat e njeriut, parimet demokratike dhe shtetin e së drejtës dhe në rastet serioze të korrupsionit.

c) Marrëveshja financiare mund të pezullohet për shkak të një force madhore, siç përcaktohet më poshtë. “Forcë madhore” do të thotë një situatë e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme ose ngjarje përtej kontrollit të palëve, e cila pengon palët në përmbushjen e çdo detyrimi, dhe që nuk mund t’i ngarkohet një gabimi ose pakujdesie të tyre (ose kontraktorëve të tyre, përfaqësuesve ose punonjësve), si dhe provohet të jetë e pakapërcyeshme, pavarësisht nga përpjekjet që mund të bëhen. Difektet në pajisje ose materiale ose vonesat për t’i bërë të disponueshme, mosmarrëveshjet e punës, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të konsiderohen si forcë madhore. Një palë nuk do të konsiderohet në shkelje të detyrimeve të saj, në qoftë se nuk ka mundur t’i përmbushë ato për shkak të një force madhore. Një palë që ballafaqohet me një forcë madhore duhet të informojë pa vonesë palën tjetër, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikuara të problemit. Gjithashtu ajo duhet të marrë çdo masë për të minimizuar dëmet e mundshme.

18.2 Asnjë njoftim paraprak nuk do të jepet për vendimin e pezullimit.

18.3 Në momentin e njoftimit të pezullimit, do të tregohen edhe pasojat mbi kontratat në fuqi ose kontratat që janë ende për t’u firmosur.

Neni 19

Përfundimi i Marrëveshjes financiare

19.1 Në qoftë se çështjet që shkaktojnë pezullimin e Marrëveshjes financiare nuk zgjidhen për një periudhë katërmujore, çdo palë të mbarojë Marrëveshjen financiare me dy muaj paralajmërim.

19.2 Kur një Marrëveshje financiare nuk ka filluar ndonjë pagesë brenda tre vjetësh nga nënshkrimi i saj ose kontratat e zbatimit nuk janë firmosur sipas datave të përcaktuara në nenin 5 të këtyre kushteve, atëherë Marrëveshja financiare do të mbarojë automatikisht.

19.3 Në momentin e njoftimit të mbarimit, do të tregohen edhe pasojat mbi kontratat në fuqi ose kontratat që janë ende për t’u firmosur.

Neni 20

Rregullat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

20.1 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me Marrëveshjen financiare, e cila nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe gjashtëmujore nga konsultimet midis palëve sipas nenit 16 të këtyre kushteve, mund të zgjidhet me anën e arbitratit me kërkesën e njëres prej palëve.

20.2 Në këtë rast, secila nga palët do të caktojë një arbitër brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës për arbitrat. Në qoftë se kjo nuk verifikohet, secila nga palët mund t’i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitratit (Hagë) të caktojë një arbitër të dytë. Dy arbitrat, nga ana e tyre, do të caktojnë një arbitër të tretë brenda 30 ditëve. Në qoftë se kjo nuk verifikohet, secila nga palët mund t’i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitratit të caktojë arbitrin e tretë.

20.3 Përveç rastit kur arbitrat vendosin ndryshe, do të aplikohen procedurat e përcaktuara në Rregullat Fakultative të Arbitrimit për organizatat ndërkombëtare dhe shtetet e Gjykatës së Përhershme të Arbitratit. Vendimi i arbitrave do të merret me shumicë votash brenda një periudhe tremujore.

20.4 Secila palë do të jetë e detyruar të marrë masat e nevojshme për aplikimin e vendimit të arbitrave.

SHTOJCA II¹

MASAT TEKNIKE DHE ADMINISTRATIVE

¹ Marrëveshja financiare Shtojca II-Programi vjetor i veprimt CARDS 2005

1. Identifikim

Zëri buxhetor	22 05 01 Asistencë për vendet në Ballkanin Perëndimor
Kosto totale	44 200 000 euro
Baza ligjore	Rregullore e Këshillit 2666/2000 e amenduar me Rregulloren e Këshillit (EC) Nr.2415/2001

2.Situata në vend

Gjatë muajve të kaluar, reformat në Shqipëri kanë qenë në përgjithësi të pamjaftueshme për të adresuar të tëra sfidat që kalonte vendi. Me rëndësi të veçantë janë çështjet që kanë të bëjnë me shtetin e së drejtës, si lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe sistemi gjyqësor. Ndërkohë që Shqipërisë mund t'i atribuohet roli përgjithësisht konstruktiv që ajo ka në rajon, ulja e trafikimit përtej Adriatikut dhe fillimi i marrëveshjes së ripranimit, rezultatet në fushat më të rëndësishme, si në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe reforma në sistemin gjyqësor dhe administratën publike, kanë qenë më pak rezultative nga sa priteshin.

Rritja e GDP-së në 2004 u vlerësua në masën 6.2% mbi 4.7% në vitin 2002 dhe 6.3% në vitin 2003. Në fund të vitit 2004, inflacioni arriti në masën 2.2%. Disa përmirësime janë bërë në fushën e privatizimit të kompanive shtetërore (Banka e Kursimeve u privatizua vitin e kaluar), gjithashtu është miratuar dhe ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave. Megjithatë, paqëndrueshmëria politike, mungesa e përqendrimit në reformat, si dhe dështimi përsa i përket investimeve infrastrukturore aq të domosdoshme, kanë rrezikuar rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe aftësinë e vendit për të lehtësuar varfërinë. Ekonomia shqiptare mbetet informale në një masë të konsiderueshme. Korrupsioni, krimi i organizuar dhe një administratë inefficente vazhdojnë të sjellin pengesa për zhvillimin e biznesit. Siguria ligjore mbetet e pamjaftueshme dhe kuadri ligjor tregtar është i papërshtatshëm. Megjithë arritjen e marrëveshjeve të tregtisë së lirë (MTL) me vendet e rajonit, Shqipëria ka treguar gjithashtu edhe kufizimet e saj në zbatimin e plotë të kalendarit të saj të OBT-së.

Shqipëria është një shtet i prekur në shkallë të lartë nga varfëria, veçanërisht në zonat rurale ku, sipas statistikave të KB-së, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë jeton me më pak se 2\$ në ditë. Shqipëria ka një shkallë të lartë të rritjes së popullsisë kryesisht për shkak të përqindjes së lartë të lindjeve (më e larta në Europë). Ndërkohë që të ardhurat nga emigrantët shërbejnë vetëm për rimëkëmbjen e ekonomisë, nga ana tjetër hasim largim të punëtorëve të arsimuar dhe të aftë (megjithëse tani kemi rënie të emigracionit). Pothuajse gjysma e popullsisë është midis moshës 5 dhe 29 vjeç, duke ndikuar në fryrje të kërkesës për arsimim dhe punësim. Migrimi nga zonat rurale në zonat e urbanizuara të Shqipërisë vazhdon, duke sjellë si rezultat situatën ku 1/3 e zgjedhësve jetojnë tashmë në qarkun e Tiranës. Ky urbanizim kaq i menjëhershëm ka sjellë probleme domethënëse në shoqëri dhe nuk është konsideruar në mënyrë adequate në planifikimin e investimeve sociale. Shpenzimet në fushën e arsimit si një pjesë e Buxhetit Shtetëror nuk po rriten me shpejtësinë e duhur për të përballuar kërkesën në rritje. Cilësia në sistemin arsimor nuk është përmirësuar, ndërkohë që arsimi dhe trajnimi profesional përpiqet të luajë një rol të rëndësishëm. Sektori i shëndetësisë përpiqet të përballojë një trashëgimi me mungesë në investime, shpërblime të ulëta të doktorëve dhe të infermierëve, si dhe spitalet e klinikat të vjetra e të keqpajisura.

1. PËRMBLEDHJA E PROGRAMIT

Stabilizimi demokratik

Tashmë Shqipëria është në një gjendje të qëndrueshme në krahasim me krizën gjatë viteve 1997-1999. Kultura demokratike konsensuale dhe respektimi i rregullit ligjor mungon. Pjesërisht përgjegjësia për këtë gjendje mund t'i atribuohet gjendjes së dobët të zhvillimit të shoqërisë civile. Edhe pse shumë OJQ ekzistojnë, ato kanë tendencën të mos kenë aftësi përkrahëse/mbrojtëse dhe nuk janë të mirëshpërndara, veçanërisht jashtë qytetit të Tiranës. Ato kanë ndërmarrë vetëm një shpërndarje të kufizuar të shërbimeve dhe të politikës së përkrahjes dhe nuk janë të afta të përballojnë një nivel të ulët të shpenzimeve publike shoqërore. Këtyre organizatave u mungon kapaciteti teknik dhe menaxhues dhe për shkak të aftësive të limituara për të gjeneruar mbështetje të brendshme financiare, ato vazhdojnë të jenë të varura, nga financimet e huaja në një masë të konsiderueshme.

Në fushën e dialogut social, sindikatat janë ndikuar nga liberalizimi dhe tranzicioni i

demokracisë. Ka pak besim publik për këto sindikata dhe ende mendohen si të lidhura me qeverinë. Atyre u mungojnë burimet financiare dhe aftësitë e nevojshme për të përballuar sfidat e tranzicionit ekonomik.

Një prirje tradicionale e qeverive të mëparshme në Shqipëri ka qenë ndikimi i tyre mbi median duke përdorur presione financiare, fiskale apo presione të tjera. Ndihet nevoja për të hartuar, zbatuar dhe konsoliduar një politikë të qartë mediatike, duke përfshirë, nëse është e domosdoshme, ndryshime ligjore, për të bërë të mundur mbrojtjen e medias nga çdo presion i këtij lloji. Në të njëjtën mënyrë ndihet nevoja për të bërë përmirësime kualitative në gazetari duke përfshirë këtu mbulimin e çështjeve të integritetit evropian.

Ndërkohë që janë bërë përmirësime për lëvizjen kundër trafikimit dhe në menaxhimin e kufijve me një ulje të vazhdueshme të migrimit/trafikimit të paligjshëm drejt BE-së përtej Adriatikut, në frontin brenda vendit neglizhohet ende trafikimi i grave dhe fëmijëve, fakt ky që shpesh ka lidhje me trafikimin e drogës. Ekziston një hendek për riintegrimin social të viktimave të trafikimit, dhe është e nevojshme të merren masa për ndërgjegjësim publik në mënyrë që të arrihet dekurajimi i trafikimit dhe përfshirja në format e tjera të krimit për ato zona të largëta të Shqipërisë ku varfëria dhe marxhinalizimi përbëjnë shkaqet kryesore të këtij fenomeni.

Politika e bashkëpunimit të shteteve përfituese

Qeveria e Shqipërisë nuk e ka kundërshtuar bashkëpunimin midis donatorëve dhe organizatave të shoqërive civile. Në të vërtetë Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale ka nënshkruar një marrëveshje për bashkëpunim me përfaqësues nga 110 OJQ në kuadrin e shpërndarjes së shërbimeve shoqërore dhe të uljes së varfërisë.

Liria e mediave në Shqipëri është e garantuar me Kushtetutë. Janë bërë disa përpjekje për të përafruar legjislacionin e mediave në Shqipëri me standardet e legjislacionit të mediave europiane. Në 2005 mund të përgatitet një ligj kundër shpifjeve dhe përgojimit që do të përqendrohet në transparencën, pronësinë ndaj mediave dhe në marrëdhëniet midis shtypit dhe publikut.

Shqetësues është fakti që procesit të stabilizimit dhe asociimit nuk mund t'i adresohen disa nga sfidat sociale me të cilat shteti po përballlet. Për shembull, duket se ekziston një politikë e mbikëqyrjes së pushtetit qendror për riintegrimin social të grave dhe fëmijëve të trafikuar. Në të kundërt, në nivel ka pasur një bashkëpunim sporadik midis disa bashkive dhe organizatave të shoqërisë civile kryesisht në lidhje me iniciativën e OJQ-ve.

Koherenca me politikën e bashkëpunimit me BE-në

Një nga objektivat kryesorë të këtij plani është rritja e pjesëmarrjes dhe e transparencës në procesin e stabilizimit dhe të asociimit, si dhe rritja e përgjegjësisë së qeverisë për politikën e saj të integritetit në Bashkimin Evropian. Qëllimi thelbësor është të arrihet të sigurohet një qeverisje e mirë, veçanërisht për ato zona të cilat mbulohen nga procesi i stabilizim-asociimit dhe për shoqërinë civile dhe qytetarët shqiptarë në një shkallë më të gjerë.

Duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjes së trafikimit, ky projekt ndihmon të trajtohet një nga çështjet më shokuese në lidhje me të drejtat gjinore dhe të fëmijëve me të cilat Shqipëria po përballlet në ditët e sotme.

Duke inkurajuar në mënyrë të hapur pjesëmarrjen e popullsisë në procesin e integritetit kjo pjesë e planit të veprimt, jep kontributin e saj për zbatimin e objektivit kryesor të politikës komunitare, dhe kërkon të sigurojë gëzimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për viktimat e trafikimit dhe grupeve të tjera të dëmtuara.

Koherenca me NIP/MIP

Drejtimi i këtij projekti është në përputhje me paragrafin 3.1.1 të Programit Indikativ Shumëvjeçar 2005-06, i cili parashikon mbështetjen e OJQ-ve dhe organizatave tregtare për t'u bërë anëtare të plota të planifikimit të politikës dhe strategjisë në nivele lokale dhe qendrore (duke u përfshirë si pjesëmarrës në diskutime për procesin e stabilizimit dhe asociimit (PSA) dhe angazhimin në procesin e integritetit evropian); mbështetjen për përmirësimet në politikën e mediave; mbrojtjen dhe përmirësimin e të drejtave sociale dhe ekonomike në Shqipëri.

Projekte të identifikuar

Projekti I: Rritja e rolit të shoqërisë civile dhe të medias në procesin e integritetit evropian dhe përballimi i sfidave shoqërore.

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është rritja e nivelit të përfshirjes së shoqërisë civile në procesin e stabilizimit dhe asociimit dhe në zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Objektivat specifike janë si më poshtë vazhdojnë:

Komponenti I: Mbështetje e organizatave të shoqërisë civile-ngritja e kapaciteteve të tyre dhe përfshirje më e gjerë në debatin mbi politikën evropiane.

-Forcimi i kapaciteteve menaxhuese të OJQ-ve shqiptare, organizatave tregtare dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile.

-Inkurajimi i përfshirjes së tyre në debatin politik dhe në hartimin e politikave, veçanërisht në kuadrin e PSA dhe integritetit evropian.

Komponenti II: Mbështetja e mediave shqiptare dhe përfshirjes së tyre në debatin për politikën evropiane.

-Konsolidimi i politikës së mediave shqiptare dhe fuqizimi i kapaciteteve të tyre gjatë procesit të monitorimit të qeverisë, veçanërisht në menaxhimin e PSA dhe integritetit evropian.

Komponenti III: Mekanizëm financimi për ofrimin e shërbimeve me natyrë sociale nga shoqëria civile.

- Inkurajimi i përfshirjes së OJQ-ve në trajtimin e viktimave të trafikimit dhe më në përgjithësi në ofrimin e shërbimeve sociale, veçanërisht për zonat më të varfra të Shqipërisë.

MIRËQEVERISJA DHE NDËRTIMI I INSTITUCIONEVE

Gjatë 3 viteve të fundit Policia Shtetërore Shqiptare i është nënshtruar një sërë reformave të rëndësishme. Përfundimi i strategjisë së logjistikës dhe menaxhimit të policisë në Shqipëri, si dhe zbatimi i reformës së strategjisë për policinë, ligji për gradat dhe kohët e fundit, zbatimi i urdhrat të Kryeministrit për strukturën e re të policisë, të gjitha në një mënyrë ose në një tjetër kanë pasur për qëllim sigurimin e strukturave të përshtatshme, përmirësimin e koordinimit dhe prezantimin e metodave më efikase brenda strukturës së Policisë Shtetërore. Mënyra sipas së cilës policia është organizuar në ditët e sotme përputhet me modelet e përcaktuara nga autoritetet ligjore në shtetet anëtare të BE-së.

Në përpjekje për të minimizuar rrezikun e ndikimeve politike, Policia Shqiptare Shtetërore, po zhvendoset në zyra qendrore të reja, veç Ministrisë së Rendit Publik. Megjithatë, burimet policore ende menaxhohen nga kjo Ministri, situatë kjo që e kufizon mjaft autonominë e policisë dhe që mund të çojë lehtësisht në ndërhyrje politike në aktivitetin e policisë. Me ndihmën e Komunitetit dhe të donatorëve të tjerë, oficerë të specializuar të policisë tani trajnohen në luftën kundër terrorizmit dhe për përdorimin e pajisjeve speciale. Është krijuar një program i ri trajnimesh, i cili ka rritur cilësinë e trajnimit.

Megjithatë, policia ende vuan mungesën e pajisjeve më të nevojshme, infrastrukturës shpesh të papërdorshme, nevojën për specializime të mëtejshme, si dhe një mungesë të vazhdueshme të burimeve, korrupsionin e vazhdueshëm dhe krimin e organizuar. Në përgjithësi, oficerët e policisë trajnohen/kualifikohen në mënyrë jocilësore. Pjesa më e madhe e godinave të policisë, gjithashtu, janë të papërshtatshme për qëllime pune apo janë në gjendje të keqe. Trajnimet e policisë, organizimi dhe menaxhimi, si dhe bashkëpunimi midis policisë dhe gjyqtarëve ka nevojë për përmirësime të konsiderueshme.

Pra, Policia e Shtetit nuk është e aftë për të garantuar në mënyrë të kënaqshme zbatim të qëndrueshëm të ligjit, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Po kështu, agjenci të tjera kryesore të zbatimit të ligjit, siç është Zyra e Luftës kundër Pastrimit të Parave pranë Ministrisë së Financës, janë gjithashtu nën nivelin e duhur. Përveç përmbushjes së nevojave për mbështetjen teknike dhe materiale, duhet të rritet bashkëpunimi dhe besimi ndërmjet të gjitha agjencive të përfshira në luftën kundër krimit të organizuar. Rëndësi e veçantë po i kushtohet detyrës që Zyra e Prokurorisë së Përgjithshme ka për të hetuar dhe për të vlerësuar rrethanat. Deri tani, megjithatë, është siguruar një asistencë e kufizuar.

Me përjashtim të disa përmirësimeve të vogla, sistemi gjyqësor shqiptar mbetet i dobët. Kapacitetet profesionale të sistemit gjyqësor në të gjitha nivelet dhe në institucione të ndryshme janë përgjithësisht të pamjaftueshme. Gjithashtu kjo shoqërohet me infrastrukturë të papërshtatshme. Në veçanti pajisjet e burgjeve janë të papërshtatshme dhe kushtet në të cilat të burgosurit mbahen janë të rënda. Të gjitha godinat e paraburgimit janë të mbingarkuara me më shumë se 100%; shumica e tyre

janë në gjendje të rrënuar; në pjesën më të madhe të qelive nuk ka dritare; nuk ka qeli me banjë dhe ujë të rrjedhshëm; nuk ka mobilje brenda në qeli. Ky sistem mund të mbajë deri në jo më shumë se 2 vjet.

Disa ndryshime për ligjet ekzistuese kanë adresuar çështje të tilla si rrogat e gjyqtarëve dhe organizimin e gjykatës, duke përfshirë Këshillin e Lartë të Drejtësisë, megjithëse kapaciteti i KLD-së për inspektimin e aktiviteteve të gjyqtarëve mbetet i kufizuar. Nevoja për rritjen e nivelit të përgjithshëm të kompetencës së gjyqtarëve dhe prokurorëve ndihet ende.

Në vija të përgjithshme ekuilibri i pushtetit ose balancat midis pushtetit ekzekutiv dhe Parlamentit nuk janë të përsosura, ashtu siç mund të themi dhe për marrëdhëniet e Qeverisë me qytetarët e saj.

Rregulloret e Parlamentit janë duke u rishikuar në prani të të gjithë spektrit politik dhe me asistencë të OSBE-së, në mënyrë që të përputhen me kriteret e Kopenhagës të pranuar në Këshillin European më 1993.

Në kontekstin e funksionimit të ekzekutivit, Qeveria e sotme vepron me një administratë shtetërore me kushte të pafavorshme. Rrogat janë të ulta dhe në përgjithësi të pamjaftueshme për përmbushjen e nevojave të një familjeje. Ky fakt vështirëson rekrutimin, motivimin dhe mbajtjen e zyrtarëve korrektë. Edhe pse kohët e fundit po bëhen përpjekje për reformim, rekrutim, motivim dhe ngritje në karrierë, procedurat nuk janë transparente. Për këtë arsye korrupsioni dhe nepotizmi vazhdojnë të jenë problematike. Zyrat janë përgjithësisht të thjeshta dhe pa infrastrukturën e nevojshme. Nëpunësit e administratës duhet të trajnohen dhe duhet të bëhen ndryshime të vazhdueshme rrënjësore në kulturën e administratës.

Qeveria është angazhuar dukshëm në disa strategji e politika: Strategjia Kombëtare për Zhvillim Ekonomiko-Social (SKZHES, OZHM), Partneriteti European dhe Plani Kombëtar i Veprimit, Plani kundër Korrupsionit, Plani i Veprimit të Qeverisë, Programi i Investimeve Publike, si dhe strategji të ndryshme në sektorin kombëtar. Megjithatë pritet ende që këto strategji të integrohen në një të plotë koherente, e cila është plotësisht në përputhje dhe me përparësi sipas kuadrit ekonomik afatmesëm, dhe në këtë mënyrë plotësisht dhe saktësisht të financuara. Ndihet nevoja urgjente për të racionalizuar si strategjinë ashtu dhe funksionet planifikuese. Duhet të inkurajohet integrimi në kuadrin e PSA (Procesi i stabilizimit dhe asocimit). Në kushtet aktuale, burimet e pakta nga donatorët dhe, gjithashtu, investimet publike nuk janë optimale.

Në kontekstin e përgatitjes së politikave, SIGMA ka raportuar se fokusi në përgatitjen e kapaciteteve të një ministrie është më tepër ligjor, me një interes të pamjaftueshëm në drejtim të politikave të zhvillimit duke përfshirë konsultimet dhe vlerësimet e impaktit.

Zbatimi i masave të PSA-së është në proces të vazhdueshëm, megjithëse me hapa të ngadalta. Qeveria pretendon se tani është përqendruar në zbatimin e tyre. Plani i veprimit kombëtar për zbatimin e prioriteteve të Partneritetit European është krijuar si një përpjekje për të evidentuar masat kryesore që do të jenë të nevojshme për të arritur objektivat e PSA-së. Ministria e Integritimit European ka përforcuar funksionin e saj koordinues dhe gjithashtu është duke ndihmuar ministritë dhe institucionet për të krijuar një proces më efikas për formulimin e politikave dhe një planifikim strategjik në përputhje me prioritetet e PSA-së.

Në kontekstin e menaxhimit të financave publike janë bërë disa përparime. Reformat në sistemin e taksave dhe modernizimin e administrimit të sistemit kanë konsoliduar kuadrin e burimeve financiare. Me prezantimin e planit afatmesëm të shpenzimeve, Qeveria ka përmirësuar cilësinë e planifikimit për shpenzimet publike. Paralelisht me to, po bëhen përpjekje për forcimin e funksionimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Qeveria shqiptare ka miratuar strategjinë kombëtare për zhvillimin e teknologjisë së informimit dhe komunikacionit në të cilën përfshihen iniciativa *e-Government*. Strategjia parashikon përdorimin e teknologjisë së informacionit në aktivitetet e administratës publike si një mjet për mirëqeverisje duke rritur efikasitetin e shërbimeve dhe informacionit për publikun e gjerë.

Shqipëria ka nevojë për ngritje kapacitetesh të administratës për çdo funksion të qeverisë qendrore, rajonale dhe lokale. Procesi i reformës së decentralizimit ka filluar të përshpejtohet. Tashmë ekziston një kuadër ligjor, por çështja në këtë rast është nëse Qeveria mund ta kthejë legjislacionin në rregullore dhe procedura dhe nëse mund të garantojë transferimin e dobishëm dhe frytdhënës të pushtetit nga administrata qendrore në administratën lokale. Aktualisht është e vështirë që autoritetet

lokale të përmbushin funksionet e caktuara, edhe pse hartimi i ligjit “Për financat e qeverisë lokale” ka përparësi për vitin 2005. Gjithashtu rëndësi e madhe do t’i kushtohet ndarjes territoriale administrative, si dhe hartimit dhe miratimit të projektligjit “Për kriteret dhe kushtet të cilat duhen përmbushur për ristrukturimin e ndarjes territoriale administrative në Republikën e Shqipërisë”. Qeveria ka krijuar një strategji për trajnimin e strukturave të qeverisë lokale dhe ka ngritur Agjencinë e Trajnimit të Autoriteteve të Qeverisë Lokale.

Zyra Kombëtare e Statistikave (INSTAT) ka për qëllim përmirësimin e procesit të mbledhjes dhe publikimit të të dhënave në shkallë kombëtare dhe rajonale. Edhe pse kohët e fundit kjo zyrë ka publikuar tregues statistikorë rajonalë, është i nevojshëm një zhvillim i mëtejshëm për statistikën rajonale, si dhe për publikimin e të dhënave dhe shpërndarjen e tyre në shkallë kombëtare. Kapaciteti i zyrës së statistikës në shkallë kombëtare dhe rajonale duhet të arrijë në mënyrë që të sigurojë mbledhjen e të dhënave të sakta, të besueshme, në kohë dhe të plotësuara sipas standardeve ndërkombëtare europiane për përmbushjen e nevojave të klientelës.

Shërbimi Shqiptar i Doganave, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave kanë arritur të bëjnë përparime duke përforcuar kapacitetin administrativ dhe veprues në përputhje me udhëzimet e planit të Bashkimit Europian për doganat e taksat. Megjithatë, është e rëndësishme që të vazhdojë procesi i zbatimit të një plani strategjik afatgjatë për biznesin. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar mbeten ende çështje me përparësi për vendin në kuadër ndërinstitucional në lidhje të ngushtë me misionin e PAMECA II.

Politikat e shteteve përfituese në lidhje me bashkëpunim

Qeveria është pranë marrjes së vendimit për zbatimin e një sistemi të integruar planifikimi-një reformë e plotë për mënyrën e menaxhimit të investimeve publike të brendshme dhe të jashtme për qeverinë-duke njohur nevojën për të bërë ndryshime thelbësore për organizatat, mënyrën e punës dhe të sjelljes në qeverinë qendrore. Ndërkohë që sistemi i integruar i planifikimit zbatohet në mënyrë të vazhdueshme, investime nga donatorët duhet të drejtohen gradualisht më mirë dhe më eficientë. Gjatë 2005 Qeveria do të rishikojë strategjinë e saj afatmesme të zhvillimit. Një sistem planifikimi i përforcuar duhet të integrojë ngarkesën aktuale me strategji dhe politika në një strategji të vetme koherente, plotësisht në përputhje me kuadrin ekonomik afatmesëm, dhe për këtë arsye të financuar plotësisht dhe në mënyrë të përshtatshme. Kjo strategji duhet të jetë gati, të paktën në formën e një drafti, për vitin 2006. Njëra nga sfidat do të jetë sigurimi se kjo strategji e re do të pasqyrojë ashtu siç duhet urdhëresat europiane.

Raporti i progresit për strategjinë kombëtare të zhvillimit ekonomiko-social, 8 maj 2003, thekson faktin se sektori juridik mbetet me prioritet të lartë. Ky raport gjithashtu ka theksuar faktin që pa pasur investime të konsiderueshme në fushën e infrastrukturës juridike, ndikimi i Qeverisë dhe mbështetja nga donatorët për reformën e DPB-së, (Drejtësia dhe punët e brendshme) do të minimizohet.

Plani kombëtar i veprimit për partneritetin europian përcakton sfida ambicioze për Ministrinë e Rendit Publik. Përballimi i këtyre sfidave është në varësi të disponueshmërisë së burimeve të brendshme, si dhe të asistencës teknike dhe ndihmës në materiale të siguruar nga programi CARDS dhe donatorë të tjerë.

Reformimi i administratës shtetërore në Shqipëri filloi në vitin 1999 me miratimin e ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”. Partneriteti europian përfshin veprime specifike për reformimin e administratës publike si prioritet afatshkurtra dhe afatmesme për përgatitjen e Shqipërisë për integrim të mëtejshëm. Disa kapituj të hartimit të marrëveshjes për stabilizim e asocim kanë lidhje me reformën në administratën publike. Partneriteti europian përfshin disa veprime specifike për reformimin e administratës publike si pjesë përbërëse e prioritetëve afatshkurtra dhe afatmesme për përgatitjen e Shqipërisë në integrimin e saj të mëtejshëm në Bashkimin Europian. Në kontekstin e partneritetit, kuadri ligjor dhe nënligjor për decentralizimin fiskal dhe konsolidimi i administratës fiskale lokale duhet të përfundojnë brenda vitit 2004-2005.

Hyrja e Shqipërisë në Organizatën Botërore të Tregtisë është një ngjarje që në mënyrë të paevitueshme ka sjellë ndryshim në vëmendjen për fushën e doganave dhe të taksave. Në të ardhmen pritet që ndjeshmërisht të ulet sasia e të ardhurave doganore dhe të rriten të ardhurat tatimore.

Koherenca me politikën e bashkëpunimit të BE-së

Krimi i organizuar dhe korrupsioni pengojnë konsolidimin e demokracisë, formimin e institucioneve të qëndrueshme dhe të besueshme, investimet e jashtme dhe në këtë mënyrë ngadalësojnë zhvillimin ekonomik në Shqipëri. Pra lufta kundër tyre, si dhe lufta kundër trafikimit të njerëzve nxit respektimin e të drejtave të njeriut, të minoriteteve, barazisë gjinore dhe të të drejtave të fëmijëve. Integrimi i vazhdueshëm i forcave policore do të kontribuojë në mënyrë direkte në rikthimin e besimit të popullsisë tek organet e policisë, duke përforcuar kështu shtetin e së drejtës dhe duke siguruar mirë qeverisjen.

Projekti i cili i adreson çështjet e reformimit juridik, do të kontribuojë për përmirësimin e kushteve në qelitë e paraburgimit dhe do të lehtësojë aksesin në drejtësi. Ky projekt do t'i kushtojë vëmendje të veçantë çështjeve gjinore dhe veprimtarive trajnuese për këto probleme gjinore.

Çdo lloj punimi për fushën e infrastrukturës, ndërtimit apo rinovimit nga çdo projekt do t'i kushtojë vëmendjen e duhur problemit të mjedisit dhe do të zhvillohet në përputhje me kërkesat e standardet e mjedisit të përcaktura nga BE-ja.

Zbatimi i suksesshëm i dy projekteve për reformimin e administratës qendrore publike dhe decentralizimit do të japë kontribute për mirëqeverisjen dhe për funksionimin e demokracisë në Shqipëri. Decentralizimi i suksesshëm do të konsolidojë demokracinë në Shqipëri duke e sjellë procesin e vendimmarrjes më pranë qytetarëve të saj. Qytetarët do të mund ta shohin pushtetin lokal si përgjegjës të shpërndarjes së shërbimeve dhe të menaxhimit korrekt të pasurisë lokale, në vend që t'i lidhim këto funksione me pushtetin lokal të hershëm. Ky fakt gjithashtu mund të kontribuojë për krijimin e një konceptimi për qeverisje të përmirësuar në vend.

Programi i veprimtimit nuk do të vazhdojë të mbështesë vetëm aftësinë e autoriteteve shqiptare për të menaxhuar shërbimet doganore dhe të taksave, por edhe luftën e tyre kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Projekti për doganat dhe taksat do të mbështesë edhe përpjekjet e Qeverisë shqiptare për përmbytjen e kërkesave të përcaktuara në procesin e stabilizim-asocimit.

Kjo pjesë e programit vjetor të veprimtimit kontribuon për arritjen e objektivave të përgjithshëm të politikës komunitare për konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe duke forcuar përgjegjësinë institucionale për të menaxhuar dhe monitoruar procesin e zhvillimit të Shqipërisë, të zhvillimit të qëndrueshëm social dhe ekonomik.

Koherenca me NIP/MIP

Mbështetja për reformën juridike, policinë dhe luftën e shtetit shqiptar kundër krimit të organizuar janë prioritetet për dokumentin strategjik kombëtar dhe programin indikativ shumëvjeçar (MIP). Përsa i përket sistemit të drejtësisë, MIP thekson nevojën për trajnimin e gjyqtarëve, rritjen e investimeve në fushën e infrastrukturës së burgjeve dhe nevojës për forcim të institucioneve të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme. Përsa i përket policisë, MIP thekson nevojën për të fuqizuar kapacitetet dhe koordinimin e institucioneve të zbatimit të ligjit, që këto të fundit të sigurojnë shtetin e së drejtës, luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit. Të dyja këto projekte të identifikuar janë në përputhje me raportin e PSA-së dhe rekomandimet e takimeve të përbashkëta Task Force, si dhe me raportin e vlerësimit të drejtësisë dhe punëve të brendshme për Ballkanin Perëndimor.

Thellimi i reformës për administratën publike është objektiv i parë i MIP-it për të financuar në rritjen e kapaciteteve administrative. Përveç sa më sipër, MIP i referohet edhe përmirësimit të koordinimit dhe zbatimit të procesit të stabilizim-asocimit, si dhe për një menaxhim më të mirë të financave publike dhe përmirësimin e kapaciteteve për formulimin e politikave dhe planifikimit strategjik.

Mbështetja e hapur ndaj procesit të decentralizimit është një fushë relativisht e re për Komisionin në Shqipëri. Megjithatë, një paragraf i tërë i kushton rëndësi këtij procesi për decentralizim. Ky paragraf thekson nevojën për asistencë më sistematike dhe gjithëpërfshirëse për këtë proces. Referenca specifike i janë drejtuar kuadrin të rritjes së kapaciteteve të autoriteteve lokale për të kryer funksionet e tyre, ku përfshihen edhe, *inter alia*, menaxhimi i konsoliduar financiar dhe strategjitë e zhvillimit. MIP thekson rëndësinë e përforsimit të aftësive analitike lokale dhe të mbledhjes më të kujdesshme të të dhënave në nivel lokal për t'u mundësuar autoriteteve lokale marrjen e vendimeve në lidhje me zhvillimin ekonomik e social për territorin që mbulojnë në juridiksionin e tyre.

Së bashku me projektin për doganat dhe taskat, MIP kërkon të arrijë për vitin 2005 një

ekuilibër të përshtatshëm të nevojës për tregti të ligjshme dhe nevojës për mbrojtjen e të ardhurave vjetore dhe shoqërisë civile nga pasojat kundërvepruese të korrupsionit dhe krimit të organizuar duke përfshirë trafikimin dhe terrorizmin. Sipas kësaj të fundit, BE mbështet edhe përpjekjet e forcave doganore e policore shqiptare në luftën e tyre kundër trafikimit të organizuar, nëpërmjet iniciativës për krimin e organizuar.

Projekte të identifikuara

Projekti 2: Mbështetja e reformës në gjyqësor në Shqipëri

Objektivi i përgjithshëm për këtë projekt është rritja e kapaciteteve në sistemin gjyqësor dhe atë të burgjeve, në mënyrë që ato të arrijnë standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. Objektivat specifike janë si më poshtë.

Komponenti 1: Infrastruktura në gjyqësor dhe infrastruktura e burgjeve

- Përmirësimi i funksionimit të gjykatës së Dibrës dhe Sarandës sipas standardeve të BE-së dhe atyre ndërkombëtare, duke përmirësuar në këtë mënyrë aksesin në drejtësi në Shqipëri.

- Rritja e kapacitetit/cilësisë për sistemin e paraburgimit në Lezhë dhe në Berat sipas standardeve të BE-së dhe atyre ndërkombëtare, duke përmirësuar në këtë mënyrë kushtet e qëndrimit në dhomat e paraburgimit dhe duke reduktuar mbipopullimin në qelitë e këtij sistemi.

Komponenti 2: Mbështetja e Shkollës së Magjistraturës

- Fuqizimi i Shkollës së Magjistraturës, duke siguruar në këtë mënyrë qëndrueshmërinë dhe rritjen e nivelit të kompetencave të gjykatësve dhe të prokurorëve.

Komponenti 3: Mbështetja e Zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme për ndërmarrjen e inspektimeve dhe vlerësimeve të prokurorëve.

- Përforcimi i shërbimit të inspektimit dhe vlerësimeve të Zyrës së Përgjithshme të Prokurorisë, duke ngritur në këtë mënyrë nivelin profesional të prokurorëve dhe duke ulur korrupsionin në sistemin gjyqësor.

Projekti 3: Mbështetja e Policisë së Shtetit në luftën kundër krimit të organizuar, parandalimit të terrorizmit, si dhe sigurimit të integritetit të policisë.

Objektivi i përgjithshëm:

- Të kontribuojë për konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe rivendosjen e besimit të publikut në forcat e policisë duke shfarosur krimin e organizuar, parandaluar terrorizmin dhe duke siguruar integritetin e policisë.

Objektiva specifike:

- Përforcimi i kapacitetit operacional për shërbimet speciale policore të angazhuara në luftën kundër krimit të organizuar dhe parandalimin e terrorizmit.

- Rritja e kapacitetit të Zyrës së Punëve të Brendshme pranë Ministrisë së Brendshme.

Për sektorin e policisë, Komisioni ka dhënë një shumë prej 10 milionë euro për programin kombëtar të veprimit CARDS në Shqipëri për vitin 2005, nga e cila 3 milionë euro shkojnë për mbështetjen logjistike të Policisë së Shtetit (projekt Fisha 3), si dhe 7 milionë euro për vazhdimin e misionit të asistencës për policinë (PAMECA).

Projekti 4: Reforma për administratën publike në qeverinë qendrore

Objektivi kryesor është thellimi i reformës për administratën publike të pushtetit ekzekutiv, si dhe supervizioni i pushtetit ekzekutiv nga Parlamenti. Objektivat specifike janë si më poshtë:

Komponenti I: Zbatimi i sistemit të planifikimit të integruar, në kuadrin e procesit të integritetit evropian

- Sigurimi i zbatimit të sistemit të planifikimit të integruar të shpallur kohët e fundit nga Qeveria, si dhe angazhimi në sistem i Ministrisë së Integritetit Evropian për të siguruar koordinimi, përparësi dhe financimin e planit të veprimit për partneritetin evropian dhe detyrimeve të përcaktuara në kuadrin e procesit të stabilizim-asocimit, si dhe përdorim efektiv të programeve komunitare të asistencës.

Komponenti II: Përmirësimi i procesit të politikëbërjes, atij rregullator dhe mbikëqyrës

- Forcimi i kapaciteteve politikëbërëse të qeverisë qendrore dhe institucioneve, si dhe të sigurohet mbështetja për Parlamentin dhe organet rregullatore për të përmirësuar aftësinë e tyre për të siguruar funksione rregullatore dhe mbikëqyrëse.

Komponenti III: Përmirësimi i kontrollit financiar publik të brendshëm

- Forcimi i kapaciteteve të Ministrisë së Financës, ministrive të linjës, institucioneve buxhetore për të zbatuar planin e veprimit të kontrollit financiar publik, që është duke u përgatitur nëpërmjet një projekti binjakëzimi të Komisionit European.

Komponenti IV: Përmirësimi i transparencës dhe efikasitetit të procedurave administrative publike nëpërmjet teknologjisë së informimit

- Ngritja e një ambienti të mbështetur nga sistemi i teknologjisë së informimit, në të cilin institucionet publike bëhen më përgjegjëse dhe efikase ndaj publikut për shpërndarjen e informacionit dhe sigurimin e shërbimeve publike.

Projekti 5: Mbështetje e integruar për decentralizimin

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është të mbështesë procesin e decentralizimit në Shqipëri. Objektiva më specifike janë si më poshtë:

Komponenti I: Projekte pilote të zhvillimit rajonal

- Zhvillimi i mëtejshëm dhe zbatimi i strategjive të zhvillimit rajonal, të hartuara nën financime të mëparshme të programit CARDS, për këshillat e qarkut të Lezhës dhe Shkodrës, duke treguar një precedent që ka funksionuar për bashkëpunimin dhe ndarjen e përgjegjësisë midis këshillave të qarkut dhe nga ana tjetër të bashkive dhe komunave brenda territorit të tyre.

Komponenti II: Programi i infrastrukturës lokale

- Ndërtimi/rehabilitimi i infrastrukturës bazë lokale publike në Lezhë dhe Shkodër në përputhje me strategjitë e tyre të zhvillimit rajonal.

Komponenti III: Ngritja e kapacitetit të qeverisjes lokale

- Vendimmarrje në drejtim të ndarjes së përgjegjësisë midis niveleve të ndryshme të qeverisjes në përputhje me ligjin “Për decentralizimin” dhe këto vendime të zbatohen.

- Menaxhim më i mirë i përgjegjësisë të reja funksionale që u janë transferuar nëpërmjet decentralizimit në qarqe, bashki dhe komuna.

Komponenti IV: Forcimi i rrjetit të zyrave rajonale të INSTAT-it

- Përmirësimi i zyrave statistikore kombëtare dhe atyre rajonale.

- Përmirësimi i mbledhjes dhe nxjerrjes së të dhënave në nivele kombëtare dhe rajonale.

- Rritja e kapacitetit të zyrave kombëtare dhe rajonale në analizimin e të dhënave.

Projekti 6: Doganat dhe tatimet

- Qëllimi i përgjithshëm është vazhdimi i programit CAMA, në mbështetje të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Tatimeve, për të ngritur nivelin e shërbimeve të tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare, udhëzuesin e BE-së mbi tatimet dhe doganat dhe kërkesave të procesit të stabilizim-asocimit. Mbështetja për autoritetet shqiptare do të jepet në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Komponenti I: Mbështetja për doganat

- Projekti do të sigurojë mbështetje për sistemin doganor në: 1) përafrimin e legjislacionit dhe procedurave me *acquis*; 2) hetim dhe auditim 3) instalimi i plotë i ASYCUDA-s dhe i teknikave të analizës së riskut dhe 4) menaxhim i burimeve njerëzore.

Komponenti II: Mbështetja për sistemin e tatimeve

- Projekti do të sigurojë mbështetje në fushat specifike lidhur me TVSH-në dhe akcizën si: 1) përafrim i legjislacionit me *acquis*; 2) mbledhja, zbatimi i ligjit dhe kontrolli; 3) auditimi i brendshëm dhe menaxhimi i burimeve njerëzore, duke përfshirë dhe trajnime dhe 4) organizim dhe strukturim kryesisht në policinë tatimore.

Komponenti III: Iniciativa ndaj krimit të organizuar (IKO)

- Ky projekt do të mbështesë veprimtarinë e Task Forcave të përbashkëta dogana-polici, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së tyre. Me mbështetjen e një eksperti nga PAMECA, të sigurohet që rastet e trajtuara nga IKO janë ndjekur penalisht nga sistemi gjyqësor.

ZHVILLIMI EKONOMIK DHE SOCIAL

Një nga kritikantët në raportin e stabilizim-asocimit për Shqipërinë është administrimi i dobët nga ana e Qeverisë i rregulloreve që duhet të drejtojnë një ekonomi funksionale tregu. Për shembull, Drejtoria e Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë ka vetëm kapacitetet bazë. Një program për trajnimin e personelit është shumë i nevojshëm. Drafti i parë i ligjit “Për ndihmën shtetërore” është përgatitur nën projektin e vazhdueshëm CARDS dhe tani po qarkullon ndërmjet ministrive të linjës për

komente. Një inventar i skemave shtetërore të Shqipërisë ka filluar në këtë projekt, por duhet të përfundohet.

Siguria e pronës është kusht për ekonominë e tregut. Megjithatë, deri vonë regjistrimi është përqendruar vetëm në zonat rurale. Me daljen e USAID-it nga ky sektor në 2004, ka mbetur një boshllëk i madh financimi, duke lënë më pak se 20% të zonave urbane të regjistruara dhe në qytetet më të mëdha në Shqipëri procesi i regjistrimit të parë nuk ka përfunduar akoma. Kjo vonon shumë dukurinë e tregut të pronave. Ligji mbi kthimin dhe kompensimin e pronave nuk mund të zbatohet plotësisht në zonat ku nuk ka mbaruar regjistrimi i parë, pasi është e rëndësishme të identifikohen kufijtë dhe të drejtat e lidhura me një pronë përpara se ajo të kthehet apo të kompensohet. Për përfundimin e regjistrimit të parë në të gjithë Shqipërinë, kostoja e vlerësuar është më shumë se 15 milionë euro. Megjithatë, për zonat me përparësi, si Tirana dhe zonat bregdetare e qytetet kryesore, si Tirana, Durrësi, Korça, Vlora dhe Shkodra, numri i pronave që duhet të regjistrohen është afërsisht 200 000.

Sistemi i regjistrimit të pronës së paluajtshme është akoma në proces të krijimit të kapaciteteve për të siguruar një shërbim të saktë dhe efikas. Aktualisht sistemi i regjistrimit të pronës së paluajtshme kryen shumicën e punës në mënyrë mekanike, gjë që kërkon kohë dhe mund të çojë në gabime. Kapacitetet për të menaxhuar dhe përditësuar të dhënat janë të kufizuara, ndërsa ekziston rreziku që ndryshimet mekanike të informacionit mund të humbasin.

Legjislacioni shqiptar për sigurinë ushqimore kërkon që prodhuesit/importuesit të deklarojnë cilësinë dhe sigurinë e produkteve ushqimore nga prodhimi deri në produktin përfundimtar të tregtuar, ndërsa siguria duhet të certifikohet nga laboratorit. Sipas ligjit për ushqimin, disa struktura shtetërore mbulojnë aspektet e kontrollit të produktit. Këto struktura mbështeten nga laboratorët e tyre kombëtarë që, edhe pse janë të pajisur mirë nga disa programe donatorësh, vuajnë akoma nga mungesa e ekspertizës analitike të kualifikuar. Sistemi aktual i sigurisë ushqimore vuan gjithashtu nga ndarja e paqartë e përgjegjësisë dhe përdorimi joefikas i kapitalit dhe burimeve njerëzore. Një autoritet i ri kombëtar ushqimor është një strukturë shumë e kushtueshme, që do të lidhë gjithë strukturën e kontrollit ushqimor në vend. Autoriteti, në mënyrë rigorozë, do të zbatojë rregulloret dhe do të rrisë dobishmërinë e shërbimeve të kontrollit.

Problemet kryesore të nënsektorit rrugor përfshijnë: një rrjet të kufizuar rrugësh (gjatësia totale e rrugës prej 18 mijë km) me një raport të vogël të rrugëve të shtruara (12,4% të rrugëve kombëtare të shtruara); gjendja e tij e dobët, me vetëm 32% rrugë kombëtare në kushte të mira (kjo është veçanërisht në lidhje me propozimin aktual); dhe shkatërrimi i tij për shkak të mungesës së sistemit të mirëmbajtjes. Investimet gjatë viteve të fundit kanë shtuar numrin e kilometrave të rregulluara dhe të mirëmbajtura nga 5.2% në vitin 2000 në 19.4% në vitin 2003. Megjithatë, ekziston akoma nevoja për të ruajtur nxitjen për përmirësimin e infrastrukturës së mëparshme rrugore me anë të asistencës me projektim dhe mbikëqyrje si të rrugëve të reja, ashtu dhe atyre të modernizuara.

Rafineria e naftës në Ballsh prodhon 300 mijë tonë naftë të rafinuar çdo vit, por sasi të mëdha të naftës derdhen në mjedis, sidomos në lumin Gjanica dhe pusët aty afër. Projekti i financuar nga CARDS 2002 po siguron ambiente të përmirësuara për pakësimin e ndotjes në rafineri (një njësi të re të shkrupëzimit njësi të trajtimit të ujërave të ndotura dhe një zonë të sigurt ruajtjes së mbeturinave), si dhe po ndihmon në rritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mjedisit dhe aftësive mbrojtëse. Pakësimi i mëtejshëm i ndotjes kërkohet në vend, duke përfshirë trajtimin e plotë të ujërave të ndotura nga rafineria.

Ish uzina e nitrato-amonit në Fier përfshiu gjashtë linja për prodhimin e plehrave kimike duke përfshirë urenë dhe nitratin e amonit. Ndotësit përbëjnë një kërcënim për mjedisin lokal dhe shëndetin e njeriut. Përafërsisht 1400 tonë arsenik dhe tretës arseniku kërkon trajtim. Sipas programit PHARE, një ndërhyrje e punimeve të riparimit po përqendrohet aktualisht në trajtimin e tretësve me bazë arseniku, rehabilitimin e pjesshëm të zonave të ndotura dhe derdhjen e mbeturinave me bazë arseniku. Punime të mëtejshme kërkohen më tej.

Një pikë tjetër e nxehtë, platformat e naftës në Patos-Marinzë, karakterizohet nga ndotja e ajrit, tokës dhe ujit. Ekziston një studim paraprak: “Vëzhgim krahasimor i mjedisit në platformën e nafës Patos-Marinzë”, i financuar nga PHARE. Megjithatë, një vlerësim akoma më i hollësishëm nevojitet për të përcaktuar shtrirjen e plotë të ndikimit në mjedis dhe në shëndet dhe për të formuluar masat e rehabilitimit dhe të zbutjes.

Në kuadër të globalizimit në rritje dhe në bashkëpunim me vendet e tjera të rajonit, Shqipëria

përballet me presionet për të pakësuar shpenzimet sociale. Në të njëjtën kohë, aspirojnë për të ardhmen në BE, duke i vënë theksin kohezionit social dhe të drejtave sociale. Gjatë dekadave të shkuara, qeveritë e njëpasnjëshme shqiptare janë përpjekur, me ndihmën e donatorëve dhe partnerëve të tjerë, të përmirësojnë legjislacionin e mbrojtjes sociale për të plotësuar standardet, për të forcuar institucionet e përfshira dhe për të përmirësuar aftësitë dhe kapacitetet e personelit për mbrojtjen sociale. Ligji i vitit 1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” përcakton bazën për reforma në fushën e së drejtës së qytetarëve për sigurime shoqërore. Skema aktuale jofitimprurëse e sigurimeve financohet nga kontributet e punëdhënësve, të punësuarve dhe të vetëpunësuarve dhe është e pavarur financiarisht. Qeveria mban përgjegjësi për të mbikëqyrur dhe siguruar fondet. Garantohej pagimi i përfitimeve bazë minimale në para. Reforma e përgjithshme ka filluar tashmë nga Qeveria. Sfidat kryesore të sektorit kanë të bëjnë me kapacitetet dhe burimet e pamjaftueshme institucionale për të ndërmarrë reforma, nevojën për të zhvilluar kuadrin legjislativ për të zbatuar politikat e sigurimeve shoqërore dhe sistemin e dobët të mbledhjes së kontributit.

Politika e vendit përfitues në lidhje me bashkëpunimin

Plani i veprimit për tregun e tokave në Shqipëri u miratua më 1994 për të mbështetur zhvillimin ekonomik të vendit dhe për të krijuar kushtet për një ekonomi tregu funksionale. Një nga përbërësit kryesorë të këtij planveprimi ka qenë procesi i regjistrimit të parë. Qeveria e Shqipërisë ka bërë progres të pamjaftueshëm deri tani për të regjistruar si duhet pronën, me qëllim që të qartësohen të drejtat e pronës dhe pronësia e sigurt.

Qeveria, në lidhje me ndihmat shtetërore, ka bërë të qartë gatishmërinë e saj për të marrë masa, si krijimin e një autoriteti të pavarur të ndihmës shtetërore. Ajo është organizuar të vlerësojë të gjitha skemat e ndihmës shtetërore në lidhje me legjislacionin europian.

Qeveria shqiptare ka një objektiv strategjik për t’u përafruar me standardet europiane për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit. Plani kombëtar i veprimit për partneritetin europian trajton nevojën për një strukturë të përmirësuar, që do të merret me çështjen e sigurisë ushqimore, duke qartësuar që është planifikuar ngritja e një autoriteti kombëtar ushqimor në fund të vitit 2007. Ky propozim tani po diskutohet në Bordin Kombëtar të Kontrollit të Ushqimit dhe nga institucione të ndryshme.

SKZHES dhe strategjia e ndihmës për Shqipërinë e Bankës Botërore arrijnë në përfundimin që infrastruktura e transportit është një vështirësi si për sektorin privat, ashtu dhe për zhvillimin rural në Shqipëri. Plani kombëtar i transportit i shtatorit të vitit 2004 përcakton një formular përfundimtar në pritje për t’u miratuar nga Qeveria. Ky përfshin një plan investimi që përqendrohet në zhvillimin e infrastrukturës rrugore në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

Disa raporte për mjedisin, përfshirë këtu planin kombëtar të veprimit për mjedisin (2001) dhe 2 raporte të UNEP-së vënë në pah nevojën për të ulur ndotjen aktuale në disa zona të nxehta në Shqipëri. Gjithashtu zona të tjera janë identifikuar me probleme të rënda mjedisore. SKZHES identifikon uljen e ndotjeve aktuale historike si një prioritet i Qeverisë, veçanërisht në zonat e banuara. Plani kombëtar i veprimit për partneritetin europian përcakton që rehabilitimi i pikave të nxehta është përparësi që kërkon masa të menjëhershme për të mbrojtur mjedisin dhe ekonominë e komuniteteve përgjithësisht të varfra, si dhe për të shmangur ndërlikimet ndërkufitare. Është në proces një program për rehabilitimin e pikave të nxehta, ndërsa Qeveria është e angazhuar të identifikojë financime shtesë.

Përsa i përket arsimit, sistemi i arsimit të lartë ndikohet akoma nga zbatimi i ligjit të vitit 1999, që ka rritur mjaft fushën e veprimit të autonomisë financiare dhe akademike të institucioneve të arsimit të lartë, ka institucionalizuar Konferencën e Rektorëve, si organi kryesor këshillues, ka krijuar një sistem të ri akreditimi dhe ka ndryshuar kushtet për pranim në arsimin e lartë duke caktuar një provim pranimi. Reforma ka kontribuar gjithashtu në zhvillimin e arsimit pasuniversitar, ka prezantuar arsimin në distancë dhe ka nxitur miratimin e sistemit europian të transferimit të krediteve.

Ratifikimi i Konventës ILO “Për standardet minimale të sigurimeve shoqërore” dhe të Kodit Europian të Sigurimeve Shoqërore pritet të bëhet në muajt e ardhshëm. Strategjia afatmesme për shërbimet sociale (2003-2007) dhe strategjia e sigurimeve shoqërore deri në 2020 janë dokumentet bazë të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale në përpjekjet e saj për të arritur objektivat e mbrojtjes sociale dhe të sigurimeve shoqërore. Këto dokumente janë në përputhje me SKZHES dhe OZHM. Plani kombëtar i veprimit për partneritetin europian kërkon përmirësime legjislative dhe rritje të kapaciteteve institucionale për sigurimet shoqërore dhe asistencën sociale si përparësi afatshkurtër,

ndërsa bën të mundur që Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe institucionet vartëse të tij, në periudhën afatmesme, të zbatojnë masat, si decentralizimi i tij. Qeveria, aktualisht, me ndihmën e donatorëve, po përpiqet të sigurojë që ndihma sociale dhe sigurimet shoqërore të jenë të qëndrueshme me burimet që ekzistojnë në Shqipëri, në nivel kombëtar dhe lokal. Sfida e rëndësishme është tërheqja e emigrantëve për t'u bërë pjesë e sistemit të sigurimit.

Koherenca me politikën e bashkëpunimit të KE-së

Edhe pse legjislacioni shqiptar njeh të drejta të barabarta për gratë në lidhje me pronësinë dhe pronën, këto të drejta nuk janë të sigurta derisa prona është e regjistruar formalisht. Procesi i regjistrimit të parë identifikon dhe regjiston emrat e të gjithë personave që kanë të drejta ligjore për një pronë. Çdo transaksion që merr pjesë pas regjistrimit të parë duhet të tregojë miratimin me shkrim të të gjithë pronarëve, përfshirë gratë. Deri në atë kohë, tradita shqiptare lejon kreun e familjes, përgjithësisht mashkullin më të vjetër, të mbajë pronë në emër të familjes. Janë bërë të ditura rastet kur të drejtat e grave nuk janë respektuar, sidomos për shkak të divorcit apo ndarjes, duke e lënë gruan në një situatë të pambrojtur dhe të kërcënueshme. Të drejtat e pakicave mbrohen njësoj nga procesi i regjistrimit të parë.

Hartat e pronave janë përdorur nga Qeveria për planifikimin urban dhe rajonal, përmirësimin e infrastrukturës dhe sigurimin e shërbimeve shoqërore. Procesi i decentralizimit në Shqipëri është në vazhdimësi dhe në ato fusha ku regjistrimi i parë ka përfunduar, qeverisjet lokale janë në gjendje të identifikojnë menjëherë dhe të kërkojnë transferimin e pronës. Regjistrimi i parë jep informacion për vendosjet e shumta dhe zëniet e paligjshme që janë të përhapura në Shqipëri. Ka pasur shumë akuza për privatizim të paligjshëm të pronës gjatë viteve të fundit. Sidomos përgjatë vijës bregdetare dhe në zona të tjera të rëndësishme. Informacion i saktë dhe në dispozicion mbi pronësinë dhe të drejta të tjera të pronës së paluajtshme siguron transparencën e procesit të vazhdueshëm të privatizimit dhe të luftës kundër korrupsionit. Procesi mund të monitorohet dhe informacioni i saktë dhe i besueshëm për pronat mund të përdoret. Kjo vlen dhe në kuadër të ligjit mbi deklarimin e pronësishë që ka hyrë së fundmi në fuqi. Një bazë të dhënash për informacion mbi pronën është thelbësor për mbrojtjen e burimeve natyrore. Në të gjitha mënyrat, regjistrimi i parë favorizon qeverisje të mirë.

Projekte të tjera sipas kësaj fushe prioritare vlejnë për qeverisjen e mirë. Duke përmirësuar analizimin e skemave të ndihmës shtetërore, komponenti i projektit që trajton këtë fushë kontribuon në rritjen e transparencës së ndihmës që Qeveria u jep operatorëve ekonomikë. Transparenca është një kusht i domosdoshëm për besueshmërinë dhe qeverisjen e mirë. Kontrolli i ushqimit dhe sistemi i kontrollit është një nga shërbimet bazë që u ofrohet qytetarëve nga Qeveria. Qytetarët duhet të kenë besim në ushqimet që hyjnë në treg dhe, nëse nuk ndodh kështu, do të jetë e vështirë që ata t'i besojnë Qeverisë. Projekti i autoritetit ushqimor do të japë kontributin e tij për një qeverisje të mirë në Shqipëri. Forcimi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore do të ndihmojë sigurimin e përfitimeve që kanë të drejtë qytetarët. Kjo do të kontribuonte në klimën e besimit ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve shtetërore dhe do të ishte një tregues i rëndësishëm i përmirësimit të qeverisjes në Shqipëri. Përfundimi i tre komponentëve të projektit të financuar nga ndërhyrja në mjedis do të jetë fitimprurës për mjedisin shoqëror. Vlerësimi i impaktit mjedisor i lidhur me ndërtimin dhe funksionimin e zhvillimeve rrugore, që janë në fokus nga projektet rrugore do të kryhet si pjesë e një pune të hollësishme projektimi.

Kjo pjesë e planveprimit kontribuon në objektivat e përgjithshme të politikës komunitare të qëndrueshmërisë së zhvillimit ekonomik dhe social në Shqipëri dhe integritetit të mëtijshëm të vendit në ekonominë botërore sipas rregulloreve ndërkombëtare.

Koherencë me NIP/MIP

Sipas MIP-it, një nga sektorët prioritarë është zhvillimi ekonomik dhe social dhe një nga mënyrat e kësaj përparësie duhet të trajtohet përmes përmirësimit të klimës së investimeve. Qëllimi është përmirësimi dhe zbatimi i legjislacionit në këtë fushë për të përmirësuar funksionimin e tregut dhe për të rritur konkurrencën. MIP citon në veçanti ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronës. Nëse sistemi i regjistrimit të pasurisë së paluajtshme do të ishte më mirë i pajisur për rolin e tij, atëherë do të ishte në pozitë më të fortë për të përcaktuar pronën në dispozicion për kthim e kompensim. Midis programeve që do të zbatohen sipas MIP është ai i mbështetjes së regjistrimit të pronës me anë të forcimit institucional dhe përmirësimit teknik të sistemit të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, së bashku me ndihmën për të filluar Computer Assisted Mass Appraisal (CAMA). Ky program do të

jepet kontribut për qeverisje të mirë në Shqipëri. MIP i referohet gjithashtu nevojës për ndihmë për zbatimin e rregulloreve të ndihmës shtetërore. MIP rekomandon “ndihmë për të krijuar strukturën europiane të autoritetit ushqimor, që do të funksionojë si një agjenci e veçantë për çështjet e lidhura me sigurinë ushqimore”.

MIP gjithashtu trajton infrastrukturën, objektivat që “lehtësojnë Institucionin Ndërkombëtar Financiar ose donatorë të tjerë për të ndërtuar dhe përmirësuar infrastrukturën kryesore në Shqipëri, me qëllim që të kontribuohet në rritjen e tregtisë dhe zhvillimin ekonomik”. Kjo do të arrihet me anë të “përmirësimit të vazhdueshëm të rrjetit të transportit në Shqipëri” dhe “ndihmës teknike për infrastrukturën e përmirësuar me bazë të gjerë të financuar nga Institucioni Ndërkombëtar Financiar/ose donatorë të tjerë”. Programet që do të zbatohen, përqendrohen në “ndihmën për studime fizibiliteti dhe mbikëqyrje të infrastrukturës për të lehtësuar financime të tjera nga Institucioni Ndërkombëtar Financiar dhe/ose financime dypalëshe në përmirësimin e vazhdueshëm të rrjetit të transportit, sidomos në rajonet kufitare dhe në akset veri-jug dhe lindje-perëndim”.

Për mjedisin, MIP përcakton se duhet të jepet ndihmë për të arritur rezultatet e pritura nga projekte aktuale të CARDS-it. Kjo do të arrihet pjesërisht nga nxitja në angazhimet e Qeverisë për të përmirësuar kushtet mjedisore në vend, në veçanti me anë të një projekti për të trajtuar pikat e nxehta me anë të heqjes, transportit, ruajtjes dhe trajtimit të mbetjeve të rrezikshme dhe trajtimit në vend të zonave të infektuara.

MIP gjithashtu vë në pah nevojën për reforma dhe përmirësim të sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri. I referohet veçanërisht nevojës për të rritur punën e Institutit të Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri dhe agjencive të tij, dhe për të ndihmuar kompjuterizimin e tyre.

PROJEKTET E IDENTIFIKUARA

Projekti 7: Përmirësimi i klimës së investimeve në Shqipëri

Objektivi i përgjithshëm i propozimit është ta bëjë Shqipërinë një treg tërheqës të investimeve me anë të përmirësimit të klimës së investimeve. Projekti ka dy komponentë. Qëllimi i të parit është të favorizojë shfaqjen e një tregu pronash. Qëllimi i të dytit është të përmirësojë në vlerësimin e skemave të ndihmës shtetërore.

Komponenti I: Regjistrimi i pasurive të paluajtshme

Ky komponent ka dy objektiva specifike: të rrisë kapacitetin e shërbimeve të ofruara nga sistemi i regjistrimit të pasurisë së paluajtshme dhe qëndrueshmërinë e tij; dhe të përparojë drejt përfundimit të regjistrimit të parë në zonat urbane.

Komponenti II: Vlerësimi dhe përcaktimi i hartave të skemave të ndihmës shtetërore

Objektivi specifik është të përmirësojë kapacitetet e Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore për të vlerësuar skemat e ndihmës shtetërore në përputhje me kërkesat e Komisionit Europian.

Projekti 8: Krijimi i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të krijojë bazën për përmirësimin e sigurisë ushqimore në Shqipëri në përputhje me kërkesat e KE-së dhe të përforcojë standardet, duke siguruar mbrojtje të konsumatorit dhe duke inkurajuar eksportet agro-ushqimore. Objektivat specifike janë:

- Përmirësimi i kuadrit institucional, ligjor dhe administrativ i sistemit të sigurisë ushqimore në vend me anë të krijimit të një strukture të aftë për të siguruar këshillim të pavarur shkencor, teknik dhe politikash, si dhe për t'i dhënë informacionin e duhur Qeverisë, konsumatorëve dhe prodhuesve ushqimorë.

- Krijimi i bazës së shëndoshë për mbrojtjen e konsumatorit me anë të ekuilibrit institucional të përgjegjësisë dhe kompetencave ndërmjet agjencive të përfshira në sigurinë ushqimore.

- Sensibilizimi dhe përfshirja në çështjet e sigurisë ushqimore.

Projekti 9: Projektimi dhe mbikëqyrja e disa sektorëve të veçantë rrugorë

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, të ndihmojë integrimin rajonal dhe të kontribuojë në përmirësimin e standardit të sistemit rrugor në Shqipëri. Objektivi specifik është të sigurojë shërbime të projektimit të rrugëve dhe mbikëqyrjen e punimeve rrugore në përputhje me standardet ndërkombëtare për tre-katër rrugë transporti brenda korridorëve lindje-perëndim dhe veri-jug. Kjo do të lehtësojë financimin e ndërtimit të këtyre pjesëve nga Institucionet Ndërkombëtare Financiare.

Projekti 10: Trajtimi i hot spoteve në mjedis

Objektivi i përgjithshëm është të përmirësojë mjedisin në ambientet ekzistuese dhe të mëparshme industriale dhe të reduktojë impaktin negativ në shëndet në lidhje me disa pika të nxehta

dhe në të njëjtën kohë të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të cilësisë së mjedisit dhe të jetës në zonat në fjalë.

Objektivi specifik i këtij projekti është:

- Vlerësimi (me anë të një studimi) i aftësisë së sistemit për të monitoruar progresin e zbatimit të legjislacionit mjedisor, që trajton fushat e masave të kontrollit.

- Vazhdimësia dhe plotësimi i procesit të pakësimit të ndotjes në rafinerinë e naftës në Ballsh.

- Eliminimi i mbetjeve të rrezikshme me bazë arseniku dhe i mbetjeve të tjera të rrezikshme për shëndetin publik dhe mjedisin në ish-uzinën e Fierit.

- Shmangia e kërcënimeve të mundshme kundër popullsisë dhe mjedisit të shkakuar nga ndotje të grumbulluara të ekstrakteve të ujit dhe dherave dhe veprimtarisë përpunuese në zonën Patos-Marinzë.

Projekti 11: TEMPUS

Objektivi i përgjithshëm i programit TEMPUS është të nxisë zhvillimin e sistemit të lartë arsimor në Shqipëri.

Përparësia për sistemet e arsimit të lartë në Europën Juglindore është arritje e objektivave të së ashtuquajturës “Deklarata e Bolonjës”, që synon krijimin e një hapësire të sistemit të arsimit të lartë europian deri në vitin 2010. Shqipëria ka nënshkruar Deklaratën e Bolonjës në shtator 2003 në Berlin.

Projekti 12: Programet e mbështetjes së sigurimeve shoqërore

Objektivi i përgjithshëm i programit është të zhvillojë më tej sistemin e sigurimeve shoqërore sipas nevojave të shoqërisë demokratike dhe të orientuar në treg dhe të sigurojë nivelin e përjasjes me metodat e sigurimit me normat e BE-së në fushën e mbrojtjes sociale. Qëllimi i programit është të mbështesë reformat administrative sipas strategjisë së Qeverisë për sigurimet shoqërore, duke ndihmuar në konsolidimin e funksioneve bazë të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe në krijimin e bazës për përmirësime të mëtejshme në sistemin e pensioneve në Shqipëri. Objektivat specifikë janë:

- Racionalizmi i kuadrit rregullator të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin e BE-së për sigurimet shoqërore, sa më shumë të jetë e mundur.

- Prezantimi i politikave të reja dhe krijimi i mekanizmave brenda ISS-së, që synon përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të skemave të sigurimeve shoqërore, rritjen e kontributit.

- Përmirësimi i transparencës dhe i besueshmërisë në sistemin e sigurimeve shoqërore.

HAPJA E PROGRAMEVE KOMUNITARE

Hapja e programeve komunitare është një hap tjetër drejt integritetit europian.

Në axhendën e Selanikut, BE-ja vendos të hapë pjesëmarrjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor në programet komunitare sipas modelit të zgjerimit. Komisioni propozoi hapa konkrete për ta bërë këtë të mundur duke nënvizuar nevojën për një përjasje selektive dhe graduale.

Një marrëveshje kuadër me Komunitetin Europian, që përcakton kushtet e përgjithshme të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programet komunitare, do të hyjë në fuqi në fillim të vitit 2005. Pjesëmarrja në programe të përzgjedhura do t’i nënshtrohet përfundimit progresiv të memorandumeve të veçanta të mirëkuptimit, që përcaktojnë kushtet dhe afatet specifike për pjesëmarrjen. Kontributi financiar i Shqipërisë (bileta hyrëse), që kërkohet për mbulimin e shpenzimeve të pjesëmarrjes në programet e përzgjedhura, mund të paguhet pjesërisht nga buxheti i CARDS-it.

MIP veçanërisht parashikon mbështetjen e Shqipërisë për angazhimin e saj në programet komunitare me anë të dy masave: 1) duke paguar një pjesë të biletës së Shqipërisë dhe 2) bashkëfinancim të masave shoqëruuese, si përgatitje administrative, komunikim dhe trajnim të aplikantëve të mundshëm në përgatitjen e propozimeve.

Për shkak të mospërgatitjes së Shqipërisë për t’u angazhuar në programet komunitare, përcaktimi i përparësive dhe fokusi në programet që kërkojnë më pak kapacitete administrative është i nevojshëm.

4. Asistenca e KE-së në të shkuarën dhe mësimet e nxjerra

Programet e CARDS-it 2001-2003 për Shqipërinë arrijnë në 129 milionë euro, të përqendruara në reformën në drejtësi, punë të brendshme dhe në administratën publike. Gjatë vlerësimit të rregullores së CARDS-it në maj 2004, u vu re që për programet CARDS 2001-2003 ishte kontraktuar vetëm 27.4% e fondeve. Në janar 2005, projektet e kontraktuara për periudhën në fjalë arritën 72

milione euro, pra 60% të programit CARDS për Shqipërinë që ishte në proces, ndërsa shumica ishte në një fazë më të përparuar të përgatitjes për tender. Kjo pavarësisht-ashtu si vë në dukje vlerësimi-nëse Shqipëria është përfshirë në raundin e tretë dhe të fundit të decentralizimit.

Pra 35 projekte të CARDS-it ishin në zbatim në fillim të këtij viti (pa llogaritur projektet rajonale, disa projekte të vogla për infrastrukturën dhe disa projekte për shoqërinë civile). Disa nga projektet kryesore kanë përfunduar tashmë (masterplani për paraburgimin) ose janë në përfundim (strategjia për menaxhimin e migracionit).

Edhe pse vlerësimet e para të 9 projekteve ishin në proces, në kohën që po shkruajmë është tepër herët për të raportuar rezultatet e këtyre vlerësimeve specifike. Megjithatë, në terma më të përgjithshëm, vlerësimi i përgjithshëm i rregullores CARDS theksoi kapacitetin e vogël thithës të Qeverisë së Shqipërisë dhe mungesën e kuadrit të duhur ligjor për të rregulluar menaxhimin e përgjithshëm të çështjeve të BE-së në Shqipëri, duke përfshirë menaxhimin e asistencës së KE-së. Sipas këtyre rrethanave dhe për të siguruar angazhimin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë, Komisioni Europian bën çdo përpjekje për të ndihmuar në zhvillimin e ndjenjës së pronësisë nga ana e Qeverisë shqiptare. Vlerësimi i referohet veçanërisht projektit të financuar nga Komisioni, i përqendruar në Ministrinë e Integrimit Europian për forcimin e kapaciteteve kombëtare në hartimin e politikave, planifikimin, zbatimin dhe monitorimin. Pjesërisht si rezultat i këtij projekti, pjesërisht si rezultat i inkurajimit të delegacionit, Ministria e Integrimit Europian dhe ministritë e linjës janë përfshirë në të gjitha fazat e ciklit të projektit, duke përfshirë programimin dhe identifikimin. Gjatë vitit të dytë, Ministria e Integrimit Europian ka bërë identifikimin e planit të veprimit të CARDS-it, duke bashkërenduar inputet e ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera. Kjo duhet të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve brenda administratës shqiptare për të përgatitur rrugën për përfaqësimin e mbarësektoriale të përparimit.

5. Veprime plotësuese

Programi kombëtar i veprimit për Shqipërinë është i plotësuar nga/dhe i bashkërenduar me programet rajonale të CARDS-it.

Në janar të vitit 2005 u nënshkrua një Marrëveshje financiare mes Komisionit Europian dhe Qeverisë së Shqipërisë, duke konfirmuar pjesëmarrjen e kësaj të fundit në programin e ri të fqinjësisë. Shqipëria do të vazhdojë të përfitojë nga programet e ndryshme të INTERREG, gjithashtu edhe nga CADSES, që tashmë është në kuadrin e programit të fqinjësisë. Bashkëpunime të mundshme mes programit të veprimit CARDS dhe INTERREG do të vazhdojnë të shfrytëzohen në fazën e vlerësimit të projekteve CARDS.

Shqipëria pritet që në gjysmën e parë të vitit 2005 të nisë hartimin e një pakete të ndihmës makrofinanciare prej 25 milionë eurosh dhënë nga Bashkimi Europian, përfshirë një ndihmë financiare prej 16 milionë, dhe një kredi prej 9 milionë eurosh. Megjithatë kjo do të varet nga përmbushja e disa kushteve nga ana e Shqipërisë dhe nga ratifikimi parlamentar i marrëveshjes në lidhje me asistencën.

Sasi të vogla të financimit, nga zëra tematikë të buxhetit (thematic budget lines) (financimet nga OJQ-të, programi LIFE, menaxhimi i migrimit në vendet e treta) vazhdojnë të jenë të disponueshme për Shqipërinë nëpërmjet thirrjeve të herëpashershme për propozime. Nga viti 2005 Shqipëria është edhe një herë e kualifikueshme për iniciativën europiane për demokraci dhe të drejtat e njeriut.

Shqipëria përfiton gjithashtu edhe nga programi kuadër 6 i KE-së.

Informacione mbi programet e asistencës të atyre vendeve ose organizatave donatore të pranishme në Shqipëri, që i janë përgjigjur ftesës për të dërguar dhe përditësuar informacionin në lidhje me këtë, janë postuar në faqen e internetit të delegacionit të Komisionit Europian në Tiranë (www.delalb.cec.eu.int).

6. Bashkërendimi i donatorëve

Në programveprimin e vitit të kaluar u vu re se bashkërendimi i koordinatorëve në Shqipëri nuk ishte për t'u marrë shembull. Donatorët mbetën të zhgënjyer nga mungesa e hapur e interesit nga ana e Qeverisë në lidhje me integrimin e programeve të ndryshme donatore në një program koherent social-ekonomik të reflektuar në MTEF-programin buxhetor afatmesëm. Në të vërtetë, vlerësimi i programit CARDS vuri re që koordinimi me Bankën Botërore dhe donatorë të tjerë ishte veçanërisht i dobët: "ndarja e supozuar e punës, sipas së cilës CARDS do të përqendrohej në ndërtimin e institucioneve dhe Institucioni Ndërkombëtar Financiar mbi zhvillimin shoqëror dhe ekonomik, strategjia dhe roli i saj në lidhje me procesin e stabilizim-asocimit nuk është përcaktuar ende. Po ashtu,

nuk ka pasur asnjë provë të fortë përputhshmërie ndërmjet CARDS-it dhe strategjisë së UNDP-së për OMZH-në në Shqipëri.

Tani, megjithatë, Komisioni European po punon në Shqipëri si motori i përpjekjeve për të përmbushur objektivat e parashtruar në komunikatën e Komisionit të marsit 2004 mbi vënien në zbatim të konsensusit të Montereit, që kërkon respektimin nga ana e BE-së të parimit të koherencës, plotësueshmërisë dhe koordinimit në shpërndarjen e asistencës së tij të zhvillimit. Përpjekjet në lidhje me këtë duket se janë bashkuar gjatë vitit të kaluar. Sekretariati teknik i Komisionit European (i përbërë gjithashtu edhe nga OSBE, UNDP dhe Banka Botërore) është përfshirë në një proces intensiv konsultimi dhe dialogu me homologun e tij qeveritar (të kryesuar nga këshilltari ekonomik dhe Kryeministri). Pika fillestare e këtyre diskutimeve është nevoja e donatorëve që Qeveria të përmirësojë menaxhimin e asistencës së jashtme.

Si rezultat, dhe nga një prej tryezave të rrumbullakta të donatorëve, më 10 dhjetor zëvendëskryeministri u paraqiti ambasadorëve propozimet për një sistem të integruar planifikimi-një reformë të gjerë të mënyrës se si Qeveria e Shqipërisë menaxhon investimet publike, vendase dhe të huaja. Vendimi i Qeverisë për zbatimin e sistemit, që do të shqyrtohet pas komenteve të donatorëve të bashkërenduar me sekretariatit teknik, parashikohet të jepet në shkurt 2005)

Gjatë vitit 2005, pas instalimit të sistemit të integruar të planifikimit, Qeveria parashikohet të shqyrtojë strategjinë zhvilluese afatmesme. Strategjia e re do të hartohet në mënyrë që të integrojë tërësinë e strategjive dhe politikave-strategjia kombëtare për zhvillimin ekonomik dhe social, OZHM, partneriteti european dhe planet e shoqëruara me të, plani i kombëtar i veprimit, plani antikorrupsion, plani qeveritar i veprimit, programi i investimeve publike, strategjitë e shumta sektoriale-në një tërësi të vetme, koherente, plotësisht në përputhje me dhe që gëzon përparësitë sipas kuadrit ekonomik afatmesëm, dhe që më pas do të financohet plotësisht dhe siç duhet. Mesa duket, mendësia brenda Qeverisë është se theksi i integritetit european duhet të jetë politika rreth së cilës do të ndërtohet strategjia e integruar. Duhet të jetë e gatshme, të paktën në formë drafti, nga viti 2006. Pasi sistemi i integruar i planifikimit dhe strategjia të vihen gradualisht në zbatim, kjo do të bëjë që investimi i donatorëve të jetë gradualisht më i mirorientuar, më efikas dhe më efektiv. Në planin afatgjatë dhe nëse sistemi i ri planifikues rezulton i suksesshëm, atëherë Komisionit dhe donatorëve do t'u kërkohej që të financojnë vetëm ato ndërhyrje që bëjnë pjesë në strategjinë e Qeverisë. Cikli programues i Komisionit European dhe ai i Qeverisë do të koincidojnë në 2006-ën dhe kjo është një mundësi që nuk duhet të na shpëtojë.

Donatorët dëshirojnë që sekretariati teknik të mbështesë jo vetëm tryezat e rrumbullakta të donatorëve, por tërë grupet e punës në sektorin e koordinimit të donatorëve, që punojnë nën mbrojtjen e tryezës së rrumbullakët. Me mbështetjen e DfID-it, një konsultim u komisionua në vjeshtën e 2004-ës për të evidentuar se deri në ç'shikallë sekretariati teknik arriti të katalizojë grupet e punës së sektorit që të përmbushnin rolin që u takon në sistemin e integruar të planifikimit dhe për ta çuar më tej axhendën Romë/Monterej të bashkëpunimit të donatorëve, angazhimit dhe harmonizimit në Shqipëri. Si rezultat, një term reference për sekretariatit teknik që pasqyron ato objektiva, u miratua nga donatorët në tryezën e rrumbullakët të dhjetorit.

Nëse ruhet ritmi i tanishëm, atëherë Shqipëria mund të bëhet një shembull i bashkëpunimit të donatorëve, të paktën krahasuar me rastet e Mozambikut, Marokut, Vietnamit dhe Nikaraguas, të cituara në komunikatën e Komisionit.

Përsa i përket koordinimit midis Komisionit dhe shteteve anëtare, mbahen herë pas here takime të delegacionit, megjithëse puna në një temë më të gjerë të sistemit të integruar të planifikimit është prirur të ketë përparësi. Shtetet anëtare janë plotësisht të përfshira në këto diskutime dhe delegacioni me cilësinë e kryetarit të sekretariatit teknik punon në bashkëpunim të ngushtë veçanërisht me Holandën, SIDA-n dhe Ambasadën Britanike/DfID.

FUSHË/PROJEKT PRIORITAR	
STABILIZIMI DEMOKRATIK	
Rritja e rolit të shoqërisë civile dhe medias në procesin e integritetit european dhe në përballimin e sfidave sociale	2,400,000
QEVERISJA E MIRË DHE FORCIMI I INSTITUCIONEVE	

Mbështetje për reformën e gjyqësorit në Shqipëri	3,800,000
Mbështetje logjistike e Policisë së Shtetit në Shqipëri për luftën kundër krimit të organizuar, parandalimin e terrorizmit, dhe për të siguruar integritetin e policisë (pa përfshirë PAMECA-n)	3,000,000
Parashikuar për PAMECA-n	7,000,000
Reforma e administratës publike në vëmendje të Qeverisë	4,300,000
Mbështetje për decentralizimin	5,500,000
Mbështetje për doganat dhe tatimet	3,000,000
ZHVILLIMI EKONOMIK DHE SOCIAL	
Përmirësimi i klimës së investimeve në Shqipëri	3,200,000
Krijimi i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit	3,000,000
Projektim dhe mbikëqyrje e disa pjesëve të rëndësishme rrugore	3,500,000
Trajtimin e <i>hot spoteve</i> mjedisore	3,000,000
TEMPUS III	1,000,000
Programi i sigurimeve shoqërore	1,000,000
HAPAT E PROGRAMEVE KOMUNITARE	
Mbështetje për pjesëmarrjen e Qeverisë së Shqipërisë në programet komunitare	500,000
TOTALI	

VENDIM
Nr.21, datë 22.2.2006

PËR RRËZIMIN E KËRKESËS PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA
TË KRYETARIT TË KUVENDIT

Në mbështetje të neneve 75 dhe 78 të Kushtetutës, si dhe nenit 114 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzohet kërkesa e një grupi deputetësh për shkarkimin nga detyra të Kryetares së Kuvendit, zonjës Jozefina Topalli (Çoba).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Beja

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL
PËR VITIN 2005

Kuvendi i Shqipërisë,

- duke njohur rolin e rëndësishëm që ligji “Statusi i nëpunësit civil” i jep Komisionit të Shërbimit Civil në mbikëqyrjen e menaxhimit të shërbimit civil;
- duke pranuar rolin e këtij institucioni të pavarur si organi administrativ i ngarkuar për zgjidhjen e ankesave ndaj vendimeve në lidhje me nëpunësin civil;
- duke theksuar rëndësinë e forcimit të marrëdhënieve ndër-institucionale ndërmjet Komisionit të Shërbimit Civil dhe institucioneve të tjera ligjvënësë, ekzekutive, gjyqësore dhe atyre të pavarura;
- duke insistuar në domosdoshmërinë e thellimit të reformave në administratën publike, në kuadër të procesit të integritetit në BE;

Vëren:

- tejkalimin e kompetencave të Komisionit të Shërbimit Civil për sa i përket detyrave të veta ligjore për sigurimin e një administrate profesionale dhe të paanshme;
- shfaqje të mungesës absolute të objektivitetit dhe mungesë të transparencës në shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civilë ndaj administratës publike, në lidhje me të drejtat që parashikon statusi i nëpunësit civil;
- qëndrime të pajustificuara, joprofesionale, politike dhe klienteliste gjatë procesit të vendimmarrjes;

Tërheq vëmendjen:

- për punën e pamjaftueshme në përmbushjen e detyrave të tij ligjore dhe rekomandimeve të dhëna për sigurimin e një administrate profesionale dhe të paanshme në të gjitha nivelet e saj;
- për mungesën e paanshmërisë politike lidhur me gjykimet në raport me reformën administrative, si një ndër standardet që kërkon BE-ja;
- për reagim të pamjaftueshëm ndaj mosekzekutimit të vendimeve të këtij institucioni nga administrata publike;
- për heshtjen e pajustificuar ndaj nivelit të lartë të korrupsionit në administratën publike, fenomen ky i vënë në dukje veçanërisht nga raportet e institucioneve ndërkombëtare.

Kërkon për vitin 2006:

- rritjen e nivelit cilësor dhe të kapaciteteve profesionale të Komisionit të Shërbimit Civil dhe të Sekretariatit Teknik të këtij institucioni në ushtrimin e detyrave të tyre ligjore;
- krijimin e një performance të qartë në zbatimin e objektivave strategjikë për ekzekutimin e prioriteteve të partneritetit evropian, me qëllim thellimin e reformave në administratën publike në funksion të integritetit në Europë;
- ndërtimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit frytdhënës me institucionet dhe organizmat e tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë;
- rritjen e këmbënguljes së institucionit dhe dhënien e kontributit në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;
- hartimin e rekomandimeve dhe ndjekjen e tyre për përmbushjen e sugjerimeve të dhëna në nivel qendror e vendor;
- përmirësimin e rolit të Komisionit të Shërbimit Civil për mbikëqyrjen e implementimit të legjislacionit të shërbimit civil dhe në nivelin e administratës së pushtetit vendor;
- bashkëpunim me Këshillin e Ministrave për kryerjen e reformës në administratë, në përputhje me statusin e nëpunësit civil.

Tiranë, më 16.2.2006

DEKRET **Nr.4790, datë 28.2.2006**

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9 pika 7 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare, si dhe me propozim të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij:

Debatik Nazmi Curri

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

DEKRET
Nr.4791, datë 28.2.2006

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

- | | |
|--|---|
| 1.Sokol Feçorr Braho | 23.Bardhyl Dylber Kruja |
| 2.Liljana Ramazan Pfeuffer (Qerimi) | 24.Alfred Fiqiri Shtëpani |
| 3.Enxhi Alfred Liko | 25.Gjinovefa Tashuk (Pashuk) Shtëpani (Rodestani) |
| 4.Enkelejda Ysen Imeri (Xheko) | 26.Fatmir Zylfo Usha |
| 5.Albin Bashkim Imeri | 27.Ihsan Tarik Llagami |
| 6.Florian Bashkim Imeri | 28.Dittmar Ihsan Llagami |
| 7.Dragush Muharrem Avdyli | 29.Sarah Ihsan Llagami |
| 8.Artur Zenel Nora | 30.Anila Veiz Llagami (Halili) |
| 9.Shqiponja Veledin Behnke (Shaqiri) | 31.Mirjeta Hajredin Haxhillari (Lleshi) |
| 10.Mimoza Hasan Bakiri (Hasani) | 32.Jessica Arben Haxhillari |
| 11.Mario Shpend Bakiri | 33.Claudia Arben Haxhillari |
| 12.Frenki Shpend Bakiri | 34. Clara Arben Haxhillari |
| 13.Anila Veip Bele (Llanaj) | 35. Liza Mhill Meyer (Lekçaj) |
| 14.Kevin Thanasi Bele | 36.Artur Pjetër Nikolli |
| 15.Andy Françesko Gjata | 37.Violeta Gjin Nikolli (Shurbi) |
| 16.Jonel Piro Trebicka | 38.Arlen Artur Nikolli |
| 17.Artan Neshat Nano | 39.Mateo Artur Nikolli |
| 18.Hamdi Abdyl Karepi | 40.Eda Durim Nikshiqi |
| 19.Nesti Thoma Kurtiqi | 41.Valbona Halil Eibl (Gurra) |
| 20.Gjyljana Ismail Kurtiqi (Kryemadhi) | 42.Malva Durim Hatibi |
| 21.Lirika Myqerem Saegbrecht (Murataj) | |
| 22.Anila Sokrat Taho (Kola) | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**MBI BASHKËPUNIMIN NDËRMJET ORGANEVE TATIMORE QENDRORE DHE
ORGANEVE TË PUSHTETIT VENDOR LIDHUR ME ADMINISTRIMIN E TAKSËS
VENDORE MBI BIZNESIN E VOGËL DHE TATIMIT TË THJESHTUAR MBI FITIMIN**

Në mbështetje të ligjit nr.8978, datë 12.12.2002 neni 8 pika 1 “Për taksën vendore për biznesin e vogël”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 neni 32/6 pika 7 “Për tatimin mbi të ardhurat”, Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm

UDHËZOJNË:

1. TË PËRGJITHSHME

Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, organet tatimore qendrore (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e saj në rrethe) dhe organet e pushtetit vendor do të bashkëpunojnë ndërmjet tyre për një zbatim sa më efektiv të ligjit nr.8978, datë 12.12.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat””, kapitulli III/A, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin dhe të ligjit nr.8978, datë 12.12.2002 “Për taksën vendore për biznesin e vogël” dhe udhëzimeve të dala në zbatim të tyre.

Në varësi të ecurisë së zbatimit të këtyre ligjeve dhe udhëzimeve dhe problemeve që do të dalin, kur është e nevojshme, këto institucione do të bashkëpunojnë në fushat e interesit të përbashkët, si:

- Regjistrimi i tatimpaguesve;
- Shkëmbimi periodik i informacionit mbi tatimpaguesit e regjistruar;
- Shkëmbimi periodik i informacionit mbi realizimin e të ardhurave;
- Planifikimi i të ardhurave nga njësitë vendore dhe organet tatimore;
- Pagesat dhe transferimi i të ardhurave;
- Bashkëpunimi mbi unifikimin e sistemit të regjistrimit të të dhënave mbi tatimpaguesit;
- Identifikimi i tatimpaguesve të paregjistruar;
- Kontrolle të përbashkëta mbi regjistrimin;
- Konsulenca të përbashkëta, shkëmbim eksperience, trajnime të ndryshme etj.

2. MBAJTJA E REGJISTRAVE

Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i tatimpaguesve.

Në këtë regjistër do të regjistrohen të gjithë tatimpaguesit me të dhëna që lidhen me vendndodhjen e tatimpaguesve, llojin e aktivitetit etj.

Zyrat e taksave të bashkive dhe komunave, me qëllim evidentimin sa më të saktë të tatimpaguesve, kur bëjnë regjistrimin në regjistër si më lart, duhet të përdorin numrin e identifikimit të regjistrimit pranë organeve tatimore (NIPT-i) dhe kodin vendor të bashkisë ose komunës respektive.

Në kuptim të këtij udhëzimi, kodi vendor është një numër identifikimi i bashkisë ose komunës, i cili do të shërbejë për identifikimin e tatimpaguesve dhe të të ardhurave të realizuara prej tyre sipas bashkive dhe komunave respektive.

Kodi vendor përcaktohet nga Ministria e Financave dhe i njoftohet në mënyrë të unifikuar për zbatim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, degëve të tatimeve në rrethe dhe çdo bashkie dhe komune.

Kodi vendor është sipas listës bashkëngjitur këtij udhëzimi.

Për këtë qëllim, brenda datës 10 të çdo muaji, dega e tatimeve dërgon pranë çdo bashkie ose komune një listë të tatimpaguesve të regjistruar brenda juridiksionit të tyre gjatë muajit të mëparshëm. Kjo listë identifikon qartë emrin dhe NIPT-in e tatimpaguesit, adresën e vendndodhjes së biznesit dhe kodin vendor të bashkisë ose komunës.

Brenda datës 31.7.2006, degët e tatimeve në rrethe i dërgojnë çdo bashkie dhe komune kopje me të gjitha të dhënat mbi tatimpaguesit e regjistruar, përfshirë informacion të detajuar mbi pagesat fiskale të kryera nga këto subjekte që nga data 1 janar 2003.

3. SHKËMBIMI PERIODIK I INFORMACIONIT

Shkëmbimi periodik i informacionit konsiston në:

-*shkëmbimin periodik të informacionit mbi subjektet e regjistruara*

Degët e tatimeve në rrethe do t'u dërgojnë bashkive dhe komunave të rretheve respektive, çdo datë 10 të muajit pasardhës, një njoftim mbi listën e subjekteve të regjistruara si tatimpagues të biznesit të vogël, tipin e biznesit (kategorinë për efekt pagese).

Punonjësit e zyrave të taksave në bashki apo komuna, si dhe ato të policive bashkiake, në asnjë rast nuk mund të bëjnë kontrolle mbi xhiron e tatimpaguesve të juridiksionit të tyre. Ato mund të bëjnë kontrolle vetëm lidhur me identifikimin e tatimpaguesve të paregjistruar dhe të tatimpaguesve që nuk kanë paguar në kohë detyrimet e tyre, duke informuar periodikisht me shkrim degën e tatimeve të rrethit përkatës.

Kur bashkitë dhe komunat konstatojnë dhe identifikojnë subjekte të paregjistruara, raste kur tatimpagues nuk janë kategorizuar në kategorinë përkatëse, sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore, ndryshime në të dhënat e tatimpaguesit, mosrespektimin e dispozitave ligjore nga tatimpaguesit etj., dërgojnë për veprim pranë degëve të tatimeve në rrethe informacionin e mësipërm.

Degët e tatimeve përkatëse pas marrjes së informacioneve nga bashkia ose komuna për biznese të cilat nuk janë të pajisura me certifikatë regjistrimi, marrin masa për t'i regjistruar këto biznese brenda 30 ditëve pas marrjes së informacionit dhe informojnë bashkinë ose komunën për masat e marra brenda 45 ditëve.

Në raste të veçanta, informacioni verifikohet bashkërisht duke krijuar grupe të përbashkëta me përfaqësues të organeve tatimore, bashkive ose komunave.

- shkëmbimin periodik të informacionit mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave

Degët e tatimeve në rrethe do t'u dërgojnë bashkive dhe komunave të rretheve respektive, çdo datë 10 të muajit pasardhës, informacion mbi shumën e arkëtuar të taksës vendore për biznesin e vogël dhe shumën e tatimit të thjeshtëzuar mbi fitimin. Informacioni jepet i detajuar për çdo tatimpagues dhe veçmas për taksën vendore për biznesin e vogël dhe për tatimin e thjeshtëzuar mbi fitimin.

Bashkitë dhe komunat, brenda muajit korrik të vitit korrent, me vendim të këshillit vendor, përcaktojnë nivelin e taksës mbi biznesin e vogël për vitin pasardhës dhe njoftojnë për këtë degën e tatimeve të rrethit përkatës.

Degët e tatimeve, brenda muajit gusht të vitit, në bazë të numrit të subjekteve dhe kategorizimeve të tyre, kryejnë planifikimin e të ardhurave të vitit pasardhës dhe njoftojnë bashkitë dhe komunat brenda këtij afati për arsye të hartimit të projektbuxhetit nga ato.

4. PAGESA DHE TRANSFERIMI I TË ARDHURAVE

Pagesa e taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe e tatimit të thjeshtuar do të bëhet në llogarinë e degës përkatëse të tatimeve me anë të "formularit të pagesës". Ky formular përmban edhe kodin vendor të bashkisë ose komunës përkatëse, i cili shërben për ndarjen e të ardhurave për efekt të transfertës së tyre në buxhetin e bashkisë/komunës, ku është vendndodhja e biznesit të taksueshëm.

Të ardhurat nga taksa vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimin e thjeshtuar mbi fitimin transferohet brenda datës 10 të muajit pasardhës në llogaritë e bashkive/komunave përkatëse.

Ky transferim bëhet nga dega e thesarit të rrethit përkatës, në bazë të listës totale të bashkive/komunave të dërguar nga dega e tatim-taksave e rrethit brenda datës 10 të muajit pasardhës, për shumën e arkëtuar për çdo bashki/komunë.

5. KONTROLLI I PËRBASHKËT MBI REGJISTRIMIN DHE RESPEKTIMIN E DISPOZITAVE LIGJORE NGA TATIMPAGUESIT

Punonjësit e degëve të tatimeve dhe zyrave të taksave nëpër bashki e komuna, me miratimin e titullarëve respektivë, mund të ndërmarrin aksione të përbashkëta për identifikimin dhe regjistrimin e bizneseve që rezultojnë të paregjistruara, si dhe për respektimin e afateve ligjore të derdhjes së këtyre detyrimeve. Në këto grupe mund të marrin pjesë dhe strukturat e policisë tatimore dhe ato bashkiake.

6. KONSULENCA TË PËRBASHKËTA, TRAJNIME ETJ.

Organet tatimore qendrore dhe vendore, mbi bazën e kërkesave reciproke, organizojnë takime të përbashkëta në kuadër të shkëmbimit të ekperiencës.

Organet tatimore qendrore ofrojnë asistencë teknike dhe trajnime të ndryshme për organet tatimore vendore me qëllim rritjen e kapaciteteve organizative dhe menaxhimit fiskal në drejtim të administrimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore në përgjithësi dhe taksës mbi biznesin e vogël në veçanti.

7. TË TJERA

Organet tatimore qendrore dhe vendore, përveç sa parashikohet në këtë udhëzim, mund të

trajtojnë në mënyrë më të detajuar çështje të interesit të përbashkët nëpërmjet marrëveshjeve të përbashkëta që mund të lidhin për këtë qëllim.

Bashkitë dhe komunat dhe degët e tatimeve në rrethe, në bashkëpunim dhe mirëkuptim me zyrat e punës, degët e sigurimeve shoqërore, dhomat e tregtisë në rrethe dhe çdo institucion tjetër që ka kompetencë sipas ligjit në lidhje me regjistrimin dhe shlyerjen e detyrimeve fiskale e financiare të biznesit të vogël, mund të lidhin dhe zbatojnë marrëveshje me qëllim lehtësimin e procesit të regjistrimit dhe shlyerjes së detyrimeve.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I BRENDSHËM
Sokol Olldashi

VENDIM
Nr.14, datë 3.3.2006

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR TRANSMETIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE
SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT” SHA TIRANË

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13 pika 1, germa b, 15 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27, datë 30.5.2004 “Rregullorja për procedurat e licencimit”, nenet 4 pika 1 germa c, dhe 5 pika 1, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.54, datë 23.11.2004, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.3.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga OST sh.a. për marrje licence për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike, konstatoi se nga tërësia e kërkesave të parashikuara në aktet e mësipërme, OST sh.a. ka plotësuar disa prej tyre, por nuk ka plotësuar kushtet si më poshtë:

I. Në zbatim të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 33 pika 1:

1. Ndarjen e plotë të llogarive financiare nga KESH sh.a.

II. Në zbatim të rregullores për procedurat e licencimit neni 10 germa C pika 3 dhe neni 11 pika 2 paragrafi 3, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.54, datë 23.11.2004, pika II:

1. Sigurimi i aktivitetit të licencuar;

2. Raporti i ekspertit kontabël;

3. Realizimi i matjes në kufijtë e funksioneve të prodhimit dhe të shpërndarjes;

4. Transferimin e plotë të aseteve të nevojshme për realizimin e aktivitetit të transmetimit për OST sh.a. në sasi dhe në vlerë, si dhe ndarjen e plotë me KESH sh.a.

5. Pasqyrimi në statutin e shoqërisë OST sh.a. të ndryshimeve në kapitalin themeltar në përputhje me urdhrin e Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. KESH Tiranë dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i sistemit të transmetimit”.

Për sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERES-

VENDOSI:

I. Dhënie e licencës për transmetimin e energjisë elektrike shoqërisë “Operatori i sistemit të transmetimit” sh.a. me një afat kohor prej 3 vjetësh;

II. Kjo licencë jepet me kusht. Shoqëria OST sh.a. brenda afatit 31.12.2006 duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

1. Ndarjen e plotë të llogarive financiare në përputhje me ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” neni 33, pika 1.

2. Raportin e ekspertit kontabël në zbatim të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” me të gjitha ndryshimet përkatëse neni 251, 256 dhe urdhrit të Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. KESH Tiranë dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i sistemit të transmetimit” pika 3.

3. Transferimin e plotë të aseteve të nevojshme për realizimin e aktivitetit të transmetimit për OST sh.a. në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.797, datë 4.12.2003 “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i sistemit të transmetimit” sh.a. Tiranë”, pika 4, urdhrit të Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. KESH Tiranë dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i sistemit të transmetimit” pika 2.

4. Sigurimin e aktivitetit të transmetimit të energjisë elektrike në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 10 germa C pika 3.

5. Realizimin e matjes në kufijtë e funksioneve të prodhimit dhe shpërndarjes në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 11 pika 2 paragrafi 3.

6. Pasqyrimin në statutin e shoqërisë OST sh.a. të ndryshimeve në kapitalin themeltar në përputhje me urdhrin e Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i sistemit të transmetimit”.

3. Në përfundim të afatit të caktuar në pikën 2 të këtij vendimi, ERE rezervon të drejtën për ta rishikuar këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë njërive postare të qyteteve ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Për informacione më të hollësishme mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 042 555 63; ose 04 267 468

BOTIMET E TJERA TË QENDRËS SË PUBLIKIMEVE:

- 1. REGJISTRAT E NOTERISË sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.**
- 2. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË dhe të gjitha kodet e legjislacionit shqiptar.**
- 3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI të përditësuara për:**

1. PROKURIMIN	1500
PUBLIK.....	
2. NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
.....	
3. SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të).....	1500
4. TAKSAT DHE TATIMET...(suplement	1500
2006).....	
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

DOLI NGA SHTYPI:

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Doli nga shtypi më 7.3.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Mësonjëtorja”
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë